



KALLËZIM PENAL

Nr. 49 Prot.

Tiranë, më 29 Maj 2020

KALLËZUES: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm Gazment Bardhi

OBJEKTI:

1. Kallëzim për kryerjen e veprave penale të:
 - “Shkatërrimi i pronës” parashikuar nga neni 150 i K.Penal,
 - “Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera” parashikuar nga neni 154 i K.Penal,
 - “Shkatërrimi i veprave kulturore” parashikuar nga neni 160 i K.Penal,
 - “Përvetësimi të titullit apo detyrës shtetërore”, parashikuar nga neni 246 i K.Penal,
 - “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal,
 - “Shkelja e barazise se pjesëmarrësve ne tendera apo ankande publike”, parashikuar nga neni 258 i K.Penal,
 - “Korrupsioni pasiv i personave qe ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga neni 259 i K.Penal,
 - “Korrupsioni pasiv i funksionareve te lartë shtetërorë ose i te zgjedhurve vendore”, parashikuar nga neni 260 i K.Penal,
 - “Organizata kriminale” parashikuar nga neni 333 i K.Penal dhe
 - “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 334 i K.Penal.

2. Urdhërimin e vendosjes së sekuestros preventive për truallin e transferuar në favor të Bashkisë Tiranë me anë të VKM Nr. 377, datë 8.5.2020 “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë”; si dhe ndaj projektit me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”, të realizuar nga studio “BIG-BJARKE INGELS GROUP”.

KUNDËR:

Edi Rama, Kryeministër i Republikës së Shqipërisë;

Erjon Veliaj , Kryetar i Bashkisë Tirane;

Arbjan Mazniku, Ditjon Baboci, Alban Dokushi, Taulant Tusha, Erindi Bejko, Jonida Halili, Julinda Dhame, Dhimitraq Furxhi, Frida Pashako, Berta Piro, Laura Deliu, Elena Jaupaj, Jetmir Hasa, në cilësinë e nëpunësve civilë pranë Bashkisë Tiranë dhe propozues për shembjen e Teatrit Kombëtar;

Toni Gogu, Kryetar i Këshillit Bashkiak Tiranë;

Ing. Agron Hysenlliu, Ing. Afrim Cenga, Ing. Artur Hasantare, Ing. Olsi Nunaj, Ing. Elbarina Nunaj, në cilësinë e funksionarëve të Institutit të Ndërtimit;

Mariglen Qato, Drejtor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Tiranë;

Dallëndyshe Bici, Kryeinspektor i Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit;

Çdo person i pa identifikuar deri më tani nga ana jonë, por që me veprime konkrete rezulton pas hetimit që ka përgjegjësi penale.

BAZA LIGJORE: Nenet 75/a, 280 dhe 283 e vijues të K.Pr.Penale, nenet 150, 154, 160, 248, 258, 259, 260 333 dhe 334 të K.Penal, nenet 8, 9, 10 e vijues të ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ligji nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar, dhe VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit"

DREJTUAR:

Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK)

I nderuar Z. Prokuror,

Është fakt i njohur botërisht tashmë, se në orën 04:30 të datës 17 Maj 2020, godina e Teatrit Kombëtar dhe godina e Teatrit Eksperimental, u shkatërrua në kundërshtim të hapur me dispozitat ligjore në fuqi.

Këto godina mbartnin në vetvete vlera historike dhe të trashëgimisë kulturore të vendit tonë. Konkretisht, ky objekt është porositur nga Mbreti Zog, para pushtimit të Shqipërisë nga Italia dhe ka filluar ndërtimin në vitin 1938. Një nga veprimet e para është dhe nënshkrimi i Kontratës së Blerjes së truallit nënshkruar në vitin 1938 nga familja Libohova, me përfaqësuesit e shtetit italian. Në këtë kontratë thuhet specifikisht që ai që e blen truallin, nuk e përdor dot për asnjë destinacion tjetër, përveçse për Teatër. Prona ka një sipërfaqe prej 10625.31 metrash katrorë. Ky truall është blerë nga Francesco Jacomoni për llogari të Mbretërisë Italiane.

Teatri kombëtar është pjesë integrale e Kompleksit Skandërbeg, dizenuar nga arkitekti italian Giulio Berte në fund të viteve '30. Teatri Kombëtar përmban vlera të shumëfishta arkitektonike, artistike, kulturore, sociale dhe politike të shtetit shqiptar. Pra është pjesë e kujtesës historike shqiptare. Aktikekti Berte, për herë të parë përdori një përbërje të veçantë për ndërtimin e tij, që quhej "pupulit", ndaj kjo ndërtesë përmban vlera të jashtëzakonshme arkitektonike, si vepra e parë futuriste në Shqipëri dhe Ballkan.

Teatri Kombëtar u konceptua për projektme filmash, shfaqje teatri, koncerte artistike etj. Kompleksi "Skanderbeg" ka funksionuar për më shumë se 80 vite si qendra e jetës artistike, kulturore, shkencore, madje shpesh edhe politike e kryeqytetit të Shqipërisë. Teatri Kombëtar është pjesë e trashëgimisë kulturore, kujtesës historike dhe identitetit kombëtar të cilat u përkasin të gjithëve¹.

¹ Disa nga vlerësimet e ekspertëve më të mirë në vend mbi vlerat e Teatrit Kombëtar:

Aurel Plasari: <http://www.radiandradi.com/historiku-i-permbledhur-i-teatrit-kombetar-nga-aurel-plasari-korrik-2018/>

Aurel Plasari: <https://www.youtube.com/ëatch?v=2LkxdL8YEBU>

Maks Velo: <https://ndertimi.info/cfare-kishte-thene-maks-velo-per-projektin-e-teatrit-kombetar-dhe-stadiumit-ge-kishte-prishur-raportet-me-ramen/>

Maks Velo: <http://www.hapur.al/2018/06/19/video-maks-velo-ja-cilat-jane-vlerat-e-teatrit-kombetar/>

Maks Velo: <http://www.hapur.al/2018/06/19/video-maks-velo-teatri-nuk-duhet-shembur-ja-kater-probleme-ge-evidentohen/>

Fatos Lubonja dhe Robert Rakiplllari: <http://www.hapur.al/2018/03/22/teatri-kombetar-debate-ne-studio-e-hapur-rakiplllari-teatri-pretkest-per-ndertimin-e-kullave-lubonja-po-shkaterrohet-historia/>

Kreshnik Merxhani, arkitekt dhe specialist i trashëgimisë kulturore: <https://dosja.al/teatri-kombetar-i-ndertuar-me-tallash-arkitekti-merxhani-nuk-eshte-e-vertete-vetem-fasada-eshte-me-populit/>

Rubens Shima, historiani arti: <http://www.panorama.com.al/rubens-shima-nxjerr-dokumentet-per-teatrin-asnje-dite-dopolavoro/>

Ish Ambasadori Italian Foresti:

<https://www.facebook.com/SaliBerisha/videos/968044223630310/>

Në zbatim të këtyre vlerave të njohura të këtij objekti, në kohë të ndryshme janë ndërmarrë dhe veprime konkrete për ruajtjen e tij dhe identifikimin si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë historike dhe kulturore. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 180, datë 13.04.2000, vendosi shpalljen "Ansambël Monument Kulture" të aksit kryesor dhe qendrës historike të qytetit të Tiranës, ku përfshihej edhe godina e Teatrit Kombëtar, objekt i këtij kallëzimi. Vendimi është propozuar nga Edi Rama, në cilësinë e Ministrit të Kulturës në atë kohë dhe nënshkruar nga Kryeministri i asaj kohe, Ilir Meta. Në hartën bashkëlidhur këtij vendimi, kompleksi i Teatrit është shënuar me numrin 32. Në pikën 4 të këtij vendimi të Këshillit të Ministrave, parashikohej se: *"Ngarkohen Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Pushtetit Lokal dhe Ministria e Punëve Publike që, në bashkëpunim me institucionet e specializuara, të realizojnë projektin për ruajtjen dhe restaurimin e elementeve përbërës të ansamblit të mësipërm, në përgjithësi"*.

Shkresa nr. 356, datë 18.05.2004, e Institutit të Monumenteve të Kulturës, me lëndë *"Mbi dërgimin e listës së Monumenteve të Kategorisë së dytë në Qendrën Historike të Tiranës* përfshin listën e 111 objekteve të Qendrës Historike të Tiranës. Teatri Kombëtar, është i listuar si Monument Kulture me nr. 70 me shënimin anash *"ndërtesë pa vlerë"*. Pavarësisht specifikimit, Teatri Kombëtar është përsëri pjesë e listës të Monumenteve të Kulturës si objekt i kategorisë së dytë. Kjo listë vjen në vijim të ndryshimeve që solli ligji Nr. 9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore". Shkresa e drejtuar Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve z. Vaso Tole është nënshkruar nga Drejtori i IMK, Prof. Dr. Gjerak Karaiskaj.

Me Urdhrin Nr. 122, datë 05.03.2007, Ministri i Kulturës z. Bujar Leskaj, bazuar në shkresën nr. 142/1, datë 26.2.2007, më anë të së cilës propozohej lista e ndërtesave të Aksit kryesor dhe qendrës historike të Tiranës shpall Monumente të Kulturës së kategorisë së dytë.

Instituti i Monumenteve të Kulturës, me Urdhrin Nr. 1069, datë 16.07.2015, që mban nënshkrimin e Arta Dollanit, Drejtoreshë e IMK, shpall në *"mbrojtje paraprake"* disa objekte në qytetin e Tiranës bazuar në nenin 26, pika 1 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore" të ndryshuar, sipas hartës që i bashkëngjitet këtij Urdhri. Objekti i parë në listën e 39 objekteve në mbrojtje paraprake, është Teatri Kombëtar, Rruga "Sermedin Said Toptani". Me këtë shkresë urdhërohej që brenda 6 muajve të përcaktohej statusi i këtyre godinave. Gjatë kësaj periudhe ndalohej çdo ndërhyrje në gjendjen fizike të objekteve.

Pavarësisht këtij urdhri, asnjëherë nuk u bënë veprimet e nevojshme për përcaktimin e statusit final të objekteve të marra në mbrojtje paraprake nga shteti.

Me Vendimin Nr. 325, datë 12.04.2017 "Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Tiranës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth" Këshilli i Ministrave ndryshon kufijtë e Qendrës Historike të Tiranës, duke e nxjerrë kompleksin e Teatrit Kombëtar jashtë kësaj zone, më konkretisht duke parashikuar:

"1. Shpalljen e Qendrës Historike të qytetit të Tiranës, sipas hartës së zonifikimit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e rregullores për administrimin e Qendrës Historike të qytetit të Tiranës dhe zonës së mbrojtur përreth, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Vendimi nr. 180, datë 13.4.2000, i Këshillit të Ministrave, "Shpallja Ansambël Monument Kulture i aksit kryesor dhe qendrës historike të qytetit të Tiranës", shfuqizohet."

Në datën 14 prill 2017, Këshilli Kombëtar i Territorit miraton Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, që përcakton Qendrën Historike të Tiranës, ku përfshihet edhe Teatri Kombëtar.

Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 582 të datës 3 tetor 2018 "Për deklarimin e qendrës historike të qytetit të Tiranës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin" ndryshon sërish kufijtë e Qendrës Historike të Tiranës, duke zvogëluar edhe më tej territorin dhe duke lënë edhe një herë jashtë kufijve të Qendrës Historike Teatrit Kombëtar dhe objekte të tjera si Muzeu Historik Kombëtar, Stadiumi, Kulla e Sahatit, etj.

Në vitin 2016, Kryeministri i vendit, Edi Rama dhe Kryetari i Bashkisë Tiranë Erion Veliaj, të dy subjekt i këtij kallëzimi, në mënyre informale dhe krejtësisht në shkelje të çdo procedure prokurimi, i kërkojnë arkitektit danez Bjark Ingels që të fillojë punën për ndërtimin e një Teatri të Ri Kombëtar në vendndodhjen e atij aktual. Ky fakt është pranuar publikisht nga vetë Arkitekti Bjark Ingels në intervistën e tij dhënë në Top Channel në datën 15.03.2018².

Siç e pranon dhe vete Arkitekti ai ka filluar punën që prej muajit Dhjetor të vitit 2016 vetëm me anë të ftesës së Kryeministrit Edi Rama dhe të Kryebashkiakut Veliaj të cilët kanë porositur kryerjen e kësaj pune.

² <https://www.youtube.com/watch?v=UnKLaLv5Z40&t=543s>

Gjithashtu në këtë intervistë rezulton fare qartë që në ndryshim nga projekti i mëparshëm ku ky arkitekt kishte konkurruar sipas procedurave standarde për prokurimet publike, kësaj here nuk kishte fare garë dhe procedurë prokurimi. Gjithashtu Bjarke Ingels e pranon dhe vete që ky është projekti i parë i këtij lloji për të pasi për herë të parë po projekton një Teatër Kombëtar ndërsa më parë kishte bërë vetëm një Teatër rajonal në Lyon të Francës. Siç shihet përzgjedhja e Arkitektit Bjarke Ingels është bërë në mënyrë abuzive, pa garë dhe duke mos respektuar dispozitat ligjore të cilat do ti përmendim më poshtë.

Plot 1 vit e 3 muaj pasi Arkitekti Bjarke Ingels kishte filluar punën për dizenjimin e projektit të Teatrit Kombëtar, pas kërkesës së Edi Ramës dhe Erion Veliaj, shoqëria "Fusha" sh.p.k. i drejtohet me anë të një shkresë (Nr. 24 Prot., datë 16.02.2018 dhe e protokolluar po të njëjtën ditë në Bashkinë e Tiranës me Nr. 6348 Prot., datë 16.02.2018) ku shpreh interesin për zhvillimin e zonës në zemër të qytetit të Tiranës, ndërmjet rrugëve "Murat Toptani" dhe "Abdi Toptani". Zonë kjo, që përfshin truallin prej 5522 m² të Teatrit Kombëtar, 2945 m² pronë publike të institucioneve qendrore dhe vendore si dhe pronë private. Kompania "Fusha" zotëronte vetëm 298 m² pronë të saj që e kishte blerë vetëm disa muaj para se të drejtonte këtë shprehje interesi për zhvillimin e zonës. Është krejt absurde që një subjekt privat të kërkojë shembjen e institucioneve me vlera të vecanta kombëtare për ta zhvilluar për qëllime përfitimi. Është gjithashtu fakt i njohur publik, që projekti që u porositë nga Kryeministri Edi Rama dhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës Erion Veliaj, është paguar zyrtarisht për kompaninë arkitekturore nga kompania private "Fusha" sh.p.k.

Nga vetë kronologjia e ngjarjeve rezulton se nuk ka qenë shoqëria tregtare "Fusha" sh.p.k. që ka kontaktuar për herë të parë arkitektin Bjark Ingels, por kanë qenë personat e kallëzuar prej nesh, Edi Rama dhe Erion Veliaj. Pasi këta dy shtetas kanë përcaktuar vetë arkitektin, pa kryer asnjë procedurë ligjore konkurrimi, kanë kontaktuar me shoqërinë "Fusha" sh.p.k. duke e përdorur si artificë që një situatë haptazi të paligjshme ta shndërronin *prima facie* si të ligjshme, në mënyrë që shoqëria "Fusha" sh.p.k. të paguante për projektin e tyre për Teatrin e Ri Kombëtar pasi më parë në objektivat e tyre e kishin prishur tanimë Teatrin Kombëtar. Numri i tenderave dhënë nga institucionet shtetërore dhe Bashkia Tiranë, pjesa më e madhe e tyre pa garë, vërtetojnë lidhjen klienteliste me shoqërinë "Fusha" sh.p.k..

Veprimet që pasojnë tregojnë që çdo veprim i kryer në bashkëpunim midis shtetasve të sipërpërmendur ka pasur si qëllim të vetëm prishjen

e Teatrit Kombëtar, uzurpimin e pronës publike dhe ndërtimin të projektit të tyre të rakorduar këtë me arkitektin Bjark Ingels.

Për t'i shërbyer këtij qëllimi, qeveria e më pas parlamenti, me votat e maxhorancës miratoi ligjin special "Fusha" me nr. 37/2018 "Per percaktimin e procedures se vecante per vleresimin, negocimin dhe lidhjen e kontrates me objekt Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godines se re te Teatrit Kombetar" në shkelje të kushtetutës dhe disa ligjeve.

Ligji nuk u dekretua nga Presidenti i Republikës dhe u kritikua edhe nga Komisioni European.

Me këmbënguljen personale të tij, ligji special u ndryshua në disa nene, vetëm duke hequr emrin e shoqërisë "Fusha" sh.p.k., por duke vendosur kriteret të tilla që vetëm ajo shoqëri mund t'i përmbushte e të fitonte projektin. Tërheqja e qeverisë erdhi si pasojë e reagimit të Komisionit Evropian. Më 07.09.2018, KE i dërgon një letër Qeverisë shqiptare, nëpërmjet të cilës ngre shqetësimin se ligji special mund të krijojë probleme me nenet 72 dhe 74 të MSA-së.

Jo vetem ky ligj ishte përsëri në shkelje të kushtetutës, legjislacionit aktual por edhe në shkelje të MSA me BE sepse nuk lejonte garën e hapur e të ndershme e duke përjashtuar të gjitha shoqëritë e BE për të marrë pjesë në tenderin për projektin e zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar dhe përreth tij. Më 20 Shtator 2018, Parlamenti miratoi ligjin me ndryshime, i cili favorizonte shoqërinë "Fusha" sh.p.k., duke qenë pronare e një prone pranë asaj të Teatrit Kombëtar.

Nga analiza e të dhënave të bëra publike, qoftë edhe nëpërmjet deklarimeve publike të vetë arkitektit z. Bjarke Ingels, ai ka marrë drejtpërdrejtë një premtim dhe ofertë të parregullt për vete [*premtimi/ftesë e bërë nga Kryeministri dhe Kryetari i Bashkisë Tiranë, që e kanë ftuar atë të realizojë këtë projekt, ndërkohë që nuk ka asnjë procedurë zyrtare dhe ligjore nga autoritetet shqiptare që të kenë bërë thirrje sipas ligjit për realizimin e një pune publike*], për të kryer një veprim në kundërshtim me detyrën e tij. Kjo për faktin se për të realizuar një projekt publik, në pronë publike [*siç është Teatri Kombëtar*], prezanton dhe paraqet si klient dhe financues të punës së tij për realizimin e projektit subjektin privat Fusha sh.p.k. [*që nuk është as pronar i godinës së Teatrit Kombëtar dhe as pronar i truallin ku është ngritur dhe ku propozohet të ndërtohet Teatri Kombëtar*]. Madje ai

pranon publikisht, në datë 12 Mars 2018³ se në rastin konkret jemi përpara një partneriteti publik privat, ndërkohë që në datën ku ai bën këtë deklaram [12 Mars 2018], apo në periudhën kur pretendon që ka nisur punë për realizimin e projektit [viti 2016], nuk është shpallur nga shteti shqiptar asnjë procedurë ligjore për partneritet publik-privat.

Në këtë rast, jemi përpara faktit që porosinë për realizimin e projektit ndaj arkitektit e bën Kryeministri dhe Kryetari i Bashkisë Tiranë në vitin 2016 (pranuar publikisht nga vetë arkitekti), ndërkohë që klient për realizimin e projektit është një kompani private Fusha sh.p.k. (që bën edhe financimin për realizimin e projektit). Ky fakt provon se jemi përpara marrjes së një përfitimi të parregullt dhe pranimit të një oferte që vjen nga një përfitim i parregullt.

Po ashtu, është fakt i njohur publik dhe i provuar me dokumente shtetërore, që trualli dhe ndërtesa e Teatrit Kombëtar, është pasuri e paluajtshme publike, në pronësi të shtetit shqiptar. Kjo provohet edhe nga Kartela e Pasurisë së Paluajtshme Vol. 30, faqe 40, me indeks harte TR-P-12, për pasurinë nr. 1/241, në zonën kadastrale 8150, ku sipërfaqja prej 5,522.70 m², brenda së cilës është edhe ndërtesa e Teatrit Kombëtar, është me pronar SHTET. Për pasojë, çdo sipërmarrje për realizimin e një projekti për zhvillimin e kësaj prone publike, mund dhe duhet të kryhet vetëm mbi bazën e një kërkesë, në përputhje me legjislacionin shqiptar, të pronarit të pronës që kërkohet të ndërtohet dhe vetëm në rastet se për këtë ka nisur një procedurë zyrtare dhe ligjore.

Rezulton e provuar, nga deklaramet e bëra publike nga shtetasi z. Bjarke Ingels që ai ka marrë një propozim privat nga Kryeministri dhe Kryetari i Bashkisë Tiranë, ndërkohë që zyrtarisht deklaron që klient në realizimin e këtij projekti është kompania private Fusha sh.p.k., e cila nuk është pronare e pasurisë së paluajtshme publike ku kërkohet të realizohet ky projekt publik.

Ky projekt është realizuar pa pasur asnjë bazë konkrete të ndonjë procedure ligjore të partneritetit publik privat, për shkak se autoritetet përgjegjëse shtetërore nuk kanë hapur asnjë procedurë të tillë në momentin e fillimit të realizimit të këtij projekti.

Në rastin konkret, vepra penale është kryer nëpërmjet realizimit të shërbimit të sipërmarrjes, në realizimin e një projekti në një pasuri

³ <http://top-channel.tv/2018/03/12/sot-projekti-i-ri-i-teatrit-flet-arkitekti-danez-trefishohet-hapesira-e-godines-se-re/>

publike, nga ana e një subjekti privat, pa patur asnjë procedurë konkrete të shpallur zyrtarisht nga shteti shqiptar për një interes të tillë në procedurë partneriteti publik privat. Për më tepër, me miratimin e ligjit *"Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar"*, autoritetet shtetërore mohojnë që ky të jetë një projekt partneriteti publik privat, duke e konsideruar atë si një projekt *sui generis* dhe që nuk rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi!

Në këtë mënyrë, një projekt arkitekturor, në një pronë publike, nuk mund të realizohet pa një konkurs projektimi sipas ligjit, pa patur asnjë marrëveshje me pronarin shtet, dhe pa patur asnjë procedurë ligjore partneriteti publik privat. Sipas legjislacionit në fuqi, sipërmarrja është kontrata me të cilën njëra palë (sipërmarrësi) detyrohet, që me mjetet e saj dhe duke marrë përsipër rrezikun, të kryejë një punë, ose të bëjë një shërbim, ndërsa pala tjetër detyrohet ta pranojë atë kundrejt çmimit të caktuar në kontratë.

Ftesa e marrë privatisht nga Kryeministri dhe Kryetari i Bashkisë Tiranë, për realizimin e një projekti publik, për llogari të një subjekti privat (Fusha sh.p.k.), provon faktin e influencës që ka arkitekti z. Bjarke Ingels, ndaj Kryeministrit dhe Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Realizimi i projektit të përgatitur prej tij, krijon bindjen e arsyeshme, bazuar në prova, se ka ndikuar në mënyrë të paligjshme, në të gjitha veprimet e autoriteteve publike shqiptare, të ndërmarra qëllimisht për t'i hapur rrugë këtij projekti. Konkretisht:

- Në vitin 2016, arkitekti z. Bjarke Ingels, deklaroi publikisht se ka marrë një ftesë nga Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama dhe Kryetari i Bashkisë Tiranë Erion Veliaj, për realizimin e projektit të Teatrit të ri Kombëtar, dhe për pasojë ka nisur punën për realizimin e projektit. Mirëpo, Kryeministri Edi Rama dhe Kryetari i Bashkisë Tiranë, deklarojnë publikisht se projekti i Teatrit të ri Kombëtar ka qenë një propozim i pakërkuar i paraqitur nga subjekti privat Fusha sh.p.k. Në paraqitjen zyrtare të projektit arkitekti z. Bjarke Ingels prezantoi se klienti i tij për realizimin e këtij projekti është Fusha sh.p.k. Ky projekt sipas dokumenteve zyrtare është paraqitur nga Fusha sh.p.k. në Bashkinë e Tiranës e më pas në Ministrinë e Kulturës në Shkurt 2018.
- Në periudhën kur arkitekti z. Bjarke Ingels deklaroi se ka nisur punë për realizimin e këtij projekti (2016), për zhvillimin e një zone urbane tek Teatri Kombëtar, që përfshin ndërtimin e Teatrit të ri

Kombëtar dhe ndërtimin, në pronë shtetërore, nga kompania private Fusha sh.p.k., të 6 Kullave biznesi, me lartësi 17-21 kate mbi tonë, dhe disa kate nën tokë, rezulton se:

a. *ka qenë në fuqi vendimi nr. 180, datë 13.04.2000* i Këshillit të Ministrave, që e konsideronte aksin kryesor të qendrës historike të qytetit të Tiranës si Ansambël - Monument Kulture, duke përfshirë brenda tij edhe Teatri Kombëtar dhe gjithë zona përreth tij. Sipas specialistëve të fushës, një godinë mund të mos ketë karakteristikat e duhura për tu shpallur monument kulture në mënyrë individuale, mirëpo kjo godinë, bashkë me tërësinë e godinave që e rrethojnë, mund të plotësojë kriteret (siç i ka plotësuar godina e Teatrit Kombëtar dhe zona rreth saj deri në vitin 2017) për të qenë Ansambël – Monument Kulture, dhe që gëzon mbrojtje të veçantë me ligj dhe ku sigurisht nuk lejohet asnjë ndërtim, përveç punimeve riparuese apo restauruese.

Pasi është njohur me iniciativën e Qeverisë Shqiptare për ta prishur këtë godinë, organizata ndërkombëtare *DoCoMoMo*, në një letër publike të 12 prillit 2018, i bën thirrje të gjitha autoriteteve përgjegjëse shtetërore shqiptare për ta ruajtur ndërtesën, të cilën e konsideron me vlerë të madhe historike dhe dokumentuese. Nga ana tjetër, ndryshe nga sa deklaroi publikisht më 12 Mars 2018, arkitekti z. Bjarke Ingels se godina aktuale e Teatrit Kombëtar nuk paraqet vlera historike, shumë personalitete të njohura vendas e të huaj, shkrimtarë, arkitektë, historianë, politikanë, etj., po protestojnë prej muajsh tashmë kundër projektit të qeverisë. "Courriers des Balkans", Reuters⁴, Il Piccolo⁵, Il Fatto Quotidiano etj., i kanë kushtuar vëmendje të madhe protestave të artistëve e qytetarëve në mbrojtje të Teatrit Kombëtar si dhe skemës jo transparente e korruptive të këtij projekti me një kompani të paracaaktuar.

Edhe Organizata Europiane EUROPA NOSTRA, Zëri i Trashëgimisë Kulturore në Evropë, i ka dërguar një letër më datë 18 Korrik 2018 Kryeministrit Edi Rama, ku i kërkon të mos e shembë godinën e Teatrit Kombëtar. Organizata Europiane EUROPA NOSTRA shprehë shqetësimin e sinqertë në lidhje me vendimin alarmues për shembjen e Teatrit Kombëtar të Shqipërisë, një objekt trashëgimie me rëndësi kulturore dhe arkitekturore të madhe për Europën. Kjo organizatë ndër të tjera i jep

⁴ <https://www.reuters.com/article/us-albania-theatre-protests/albanian-actors-protest-as-parliament-backs-national-theatre-demolition-idUSKBN1JV2ZB>

⁵ <http://m.ilpiccolo.gelocal.it/trieste/cronaca/2018/07/07/nees/difesa-del-teatro-nazionale-a-tirana-si-scatena-la-piazza-1.17038081>

përgjigje edhe qëndrimin të arkitektit z. Bjarke Ingels, duke u shprehur se: "nuk pajtohet me mendimin se kjo ndërtesë ka pak ose aspak vlerë historike, kulturore apo sociale. Përkundrazi, Europa Nostra beson se vlera e spikatur europiane e kësaj prone publike tejkalon çdo përfitim afatshkurtër që mund të vijë nga shkatërimi i saj". Për pasojë, Organizata Europiane EUROPA NOSTRA i kërkon Qeverisë Shqiptare, Bashkisë Tiranë, Ministrisë së Kulturës, si edhe të gjithë palëve të tjera të përfshira, të rikonsiderojnë vendimin e tyre për të shembur këtë monument European dhe të shqyrtojnë mundësinë të ofrojnë, të paktën, rinovimet më bazike, për ta sjellë Teatrin aktual në standarde.

b. *kanë qenë në fuqi studimet urbanistike/dokumentet e planifikimit të miratuara më parë nga KRRTRSH/KKT për territorin administrativ të Bashkisë Tiranë, duke përfshirë edhe Vendimin Nr. 1, datë 15.02.2013 "Plani i Pergjithshëm Vendor, Bashkia Tiranë", ku parashikohet se në zonën e Teatrit Kombëtar dhe përreth tij, nuk lejohej ndërtimi dhe se ajo zonë konsiderohej zonë e mbrojtur, për shkak se përfshihej në zonën e Ansamblit Monument Kulture.*

Të dyja aktet si më sipër ishin pengesë ligjore për të realizuar një projekt zhvillimor në atë zonë, që parashikonte shembjen e godinës ekzistuese historike të Teatrit Kombëtar, dhe përmban ndërtimin e 6 Kullave për biznes, banim dhe shërbim.

Për t'i hapur rrugë zhvillimit të asaj zone, sipas projektit që po hartonte arkitekti z. Bjarke Ingels, që në vitin 2016, Qeveria shqiptare dhe institucionet përgjegjëse shqiptare, rezultoi e provuar që të kenë ndërmarrë këto veprime, pas fillimit të punës për realizimin e projektit, por përpara paraqitjes zyrtare të propozimit të pakërkuar nga Fusha sh.p.k.:

a. *Me vendimin nr. 325, datë 12.4.2017 të Këshillit të Ministrave, është vendosur të hiqet Teatri Kombëtar dhe zona rreth tij nga pjesa e Qendrës Historike të qytetit të Tiranës (edhe pse kjo zone është pjesë e zonës ku ndodhet Kalaja e Tiranës!). Në këtë mënyrë është shfuqizuar vendimi nr. 180, datë 13.04.2000 i Këshillit të Ministrave. Për pasojë, historia e qytetit dhe objektet që përfshihen në trashigiminë kulturore, nuk përcaktohen më nga vlerat që ato përfaqësojnë (të cilat nëse i kanë plotësuar në vitin 2000, ska asnjë arsye historike/teknike për t'i humbur këto vlera 17 vjet më vonë), por nga vullneti i një arkitekti dhe subjekti privat, se ku dhe si ato duan të ndërtojnë. Në një shoqëri demokratike kjo është e papranueshme, aq më tepër që trashëgimia kulturore e një shteti, nuk është pasuri vetëm e atij shteti, por e të gjithë njerëzimit.*

b. *Është miratuar me vendimin nr. 1, datë 14.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit, Plani i ri i Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Tiranë, duke shfuqizuar në atë mënyrë vendimin Nr. 1, datë 15.02.2013 të KKT "Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tiranë". Ndërtimet në Tiranë bëhen në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) dhe rregullores së tij. Ai përcakton me rreptësi kush ka të drejtë të ndërtojë, çfarë ndërtimi lejohet të kryejë, sa për qind të pronës së vet mund të zhvillojë, kur mund të bëjë marrëveshje zhvillimi me bashkinë, çfarë duhet t'i japë bashkisë dhe çfarë mund të kërkojë si përfitim në këmbim etj. Nëse zonat e tjera të Tiranës e kanë sipërfaqen totale të ndërtimeve të lejuara të përcaktuar me metra katrorë, intesitetin e ndërtimit të përcaktuar 2, 2.5, 3, koeficientin e shfrytëzimit të truallit jo më të lartë se 45%, numrin e kateve, si rregull, jo më shumë se 9 kate mbi tokë, për zonën e Teatrit Kombëtar dhe rreth tij, nuk vendoset asnjë kufizim dhe lihet e hapur dhe e pacaktuar.*

c. *Më 13 Mars 2018⁶, Edi Rama do të deklaronte se: "Teatri do të shembet. Do shembet, sepse është jashtë çdo lloj standardi për t'u konsideruar një teatër komune, jo më Teatri Kombëtar i një vendi.Duke ardhur tek Teatri i ri, projektin e të cilit, unë jam realisht shumë i nderuar të them që do ta prezantojë një nga arkitektët, sot më në zë në skenën e arkitekturës bashkëkohore. Teatri është pjesë e një propozimi për një Partneritet Publik Privat. Shteti, shoqëria, qyteti, Shqipëria do të përfitojnë ndërtimin e Teatrit, me një buxhet që ky shtet nuk do ta bënte dot bashkë as për 15 vjet për t'ia dedikuar Teatrit. Financimi që do bëhet drejtpërdrejtë nga sipërmarrësi privat për Teatrin Kombëtar, që do t'i jepet në dorëzim si pronë publike shtetit shqiptar. Natyrisht sipërmarrësi, kompania nuk do vijë të bëjë Teatrin, edhe të shkojë në falimentim. Në pjesën tjetër do bëjë zhvillimet e veta, që do jenë pjesë integrale e zhvillimit të qendrës së re të kryeqytetit, për të cilën do flasë vetë arkitekti.Pas shqyrtimit të propozimit nga pikëpamja formale, ne do të hartojmë projektligjin dhe ky projekt do bëhet me ligj të veçantë nga Parlamenti i Shqipërisë.....Duke falënderuar përzemërsisht arkitektin për prezantimin, dua të them se me këtë prezantim mbyllet mbledhja e 20 viteve dhe fillon puna për të bërë Teatrin e ri Kombëtar, një Teatër që, siç e patë dhe siç për mua është shumë e lehtë të parafytyrohet, duke u kthyer në realitet, do jetë padiskutim një nga teatrot më të bukur bashkëkohorë, të ndërtuar rishtas, të Europës.....Patjetër që ne do të avancojmë me vullnetin që ky Teatër të ndërtohet brenda 3 viteve të ardhshme dhe i gjithë projekti do fillojë nga Teatri. Teatri do jetë faza e parë dhe prioritare e projektit.*

⁶ <https://kryeministria.al/newsroom/teatri-ri-kombetar-shembelltyre-e-ambicies-per-shqiperine-ge-duam-2/>

Garancia e ndërtimit të tij brenda 3 viteve do jetë pjesë e procesit që ne kemi tani detyrë të ndërmarrim, përmes një procedure që do finalizohet me ligjin e Kuvendit të Shqipërisë për një investim kaq të madh për kulturën, por një investim kaq të madh edhe për Tiranën, sepse ndërkohë, studio do të zhvillojë dhe pjesën tjetër. Unë jam i bindur që kur i gjithë blloku zhvillimor do jetë i plotë, do të jetë një tjetër vlerë e madhe e shtuar nga të gjitha pikëpamjet për kryeqytetin.”.

I gjithë ky deklaram i Kryeministrit përmbledhet në këto veprime:

- a) Kryeministri ka caktuar që projekti do të zhvillohet sipas një procedure partneriteti publik-privat;
- b) Kryeministri ka caktuar studion arkitekturore dhe projektin fitues;
- c) Kryeministri ka shpallur projektin fitues, duke paracaktuar subjektin privat dhe duke urdhëruar eliminimin e garës për realizimin e këtij projekti;
- d) Kryeministri ka caktuar që realizimi i projektit nuk do bëhet sipas ligjeve në fuqi, por sipas një procedure ekstraligjore, me ligj të posaçëm;
- e) Kryeministri ka caktuar sesi do të zhvillohet zona përkatëse.

Deklarimi i Kryeministrit është bërë më datë 13 Mars 2018, ndërkohë që asnjë institucion shtetëror kompetent nuk kishte ende një vendimmarrje mbi propozimin e paraqitur nga subjekti privat Fusha sh.p.k., madje rezulton se Ministria e Kulturës aq që e kishte marrë atë në shqyrtim ende.

Sipas të dhënave zyrtare⁷, të paraqitura zyrtarisht në Kuvend, institucionet shtetërore kanë ndjekur këto hapa:

- i. Nga Bashkia Tiranë është paraqitur kërkesa me nr.6848/1, datë **23.2.2018 (18 ditë përpara prezantimit si projekt fitues nga Kryeministri)**, pranë Ministrisë së Kulturës, për shprehje interesi për zhvillimin e zonës pranë Teatrit Kombëtar të subjektit “Fusha”, sh.p.k.
- ii. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ministria e Kulturës, me shkresën e datës **29.3.2018 (16 ditë pas prezantimit si projekt fitues nga Kryeministri)**, i ka kthyer përgjigje Bashkisë Tiranë ku i parashton pengesat për të realizuar vetë investimin, lidhur me fondet në dispozicion, dhe i kërkon asaj informacion më të plotë lidhur me projektin e propozuar nga subjekti privat.
- iii. Me shkresën e Bashkisë Tiranë nr.6848/6, datë **14.5.2018 (2 muaj pas prezantimit si projekt fitues nga Kryeministri)**, kjo e fundit i ka përcjellë Ministrisë së Kulturës të gjithë informacionin

⁷ <http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/RELACIONGODINAEREETEATRIT.pdf>

- që disponon lidhur me investimin, pronën dhe orientimin ligjor për realizimin e investimit.
- iv. Në lidhje me objektin e Teatrit Kombëtar, vet institucioni i është drejtuar Institutit të Ndërtimit, me shkresën nr.186/1, datë **9.3.2018 (pas paraqitjes së propozimit nga subjekti privat Fusha sh.p.k.)**, ku i ka kërkuar vlerësimin e gjendjes së godinës.
 - v. Me shkresën e Institutit të Ndërtimit nr.75/1, datë **23.3.2018, (10 ditë pas prezantimit si projekt fitues nga Kryeministri)** është kthyer përgjigje për Teatrin Kombëtar, duke i bashkëlidhur raportin mbi vlerësimin teknik të godinës.
 - vi. Në vijim, Ministria e Kulturës, me urdhrin nr.315, datë **16.5.2018 (2 muaj e 3 ditë pas prezantimit si projekt fitues nga Kryeministri)**, ngre grupin e punës për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimit të Bashkisë Tiranë lidhur me kërkesën për zhvillimin e zonës pranë Teatrit Kombëtar.
 - vii. Grupi i punës, me shkresën nr.3427/1, datë **16.5.2018 (2 muaj e 3 ditë pas prezantimit si projekt fitues nga Kryeministri)**, ka shqyrtuar propozimin dhe ka dalë në konkluzionin se: Për ecurinë e mëtejshme të kësaj procedure, duke parë kompleksitetin e çështjes në fjalë, në procesin e shqyrtimit të kësaj praktike duhen përfshirë, sipas ligjit, edhe institucionet, të cilat prekin fushat përkatëse, jo vetëm Ministria e Kulturës, e cila mbulon fushë e politikave në kulturë.
 - viii. Ministria e Kulturës, me shkresën nr. 3466, datë **17.5.2018 (2 muaj e 4 ditë pas prezantimit si projekt fitues nga Kryeministri)**, i është drejtuar Kryeministrit, duke e vënë në dijeni të të gjitha procedurave të hartuara nga ana e saj lidhur me këtë kërkesëpropozim si dhe opinionin e grupit të punës të ngritur me urdhër të Ministrisë së Kulturës.
 - ix. Kryeministria (**më shumë se 2 muaj pas prezantimit si projekt fitues nga Kryeministri**) vendosi të marrë parasysh kërkesën e Ministrisë së Kulturës, duke i dërguar shkresë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për nevojshmërinë e përfshirjes së këtij institucioni në procedurë.

d. Më tej, për t'i hapur rrugë realizimit pikërisht të këtij projekti, *Qeveria hartoi një projektligj të posaçëm dhe individual⁸*, vetëm për të eliminuar garën dhe shmangur nga zbatimi ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat". Qeveria nuk ka bërë vetë asnjë studim feabiliteti apo analizë kostoje dhe përfitimi, apo analizë financiare të projektit zhvillimor në fjalë. Sipas ligjit të miratuar, kontrata do të bazohet në Termat e Referencës që ka hartuar dhe propozuar vetë

⁸ <http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/GODINAEREETEATRIT.pdf>

kompania "Fusha" sh.p.k., ku përfshihet pikërisht projekti i realizuar nga arkitekti z. Bjarke Ingels!

Ky veprim i Qeverisë u krye edhe pse ajo zyrtarisht ka deklaruar se propozimi për zhvillimin e asaj zonë dhe krijimin e këtij partneriteti publik privat, ka ardhur nga kompania private "Fusha" sh.p.k., e cila ka paraqitur një propozim të pakërkuar. Mirëpo, një projekt i tillë qartësisht përfshihet në fushën e veprimit të ligjit nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat", i ndryshuar⁹, dhe për të cilin ndiqen të gjitha fazat dhe procedurat që parashikon ky ligj. Në asnjë rast, ligji nr. 125/2013 nuk parashikon që projekti i pakërkuar përzgjidhet automatikisht, por ai shërben si pikënisje e procedurës për realizimin e projektit të partneritetit publik-privat, për të cilin zbatohen dispozitat e vetë ligjit, dhe që udhëhiqet nga parimet e transparencës, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, efikasitetit, trajtimit të barabartë, reciprocitetit dhe të sigurisë ligjore. Në këtë kuptim, duhej të zhvillohej një procedurë transparente konkurimi, sepse vetëm në këtë mënyrë maksimalizohet përfitimi i shtetit dhe mbrohet interesi publik.

Fakti që "Fusha" sh.p.k., që prezantohet zyrtarisht si klient nga arkitekti z. Bjarke Ingels, është një nga disa pronarët privatë që kanë pasuri të paluajtshme në zonën përreth Teatrit Kombëtar¹⁰ (*në sipërfaqe të vogla që bëjnë vetëm rreth 10 % të të gjithë sipërfaqes që përdoret për realizimit të projektit, ku pjesa tjetër e sipërfaqes është pronë publike*), nuk nënkupton që në rastin konkret nuk duhet zbatuar ligji për partneritetin publik privat apo për konkursin e projektimit, për shkak se bëhet fjalë për një kontratë punësh publike. Ligji nr. 125/2013, parashikon qartë që ky është rast tipik i partneritetit publik privat, ku partneri privat, ngarkohet me përgjegjësinë që të sigurojë parakushtet e nevojshme për t'u ofruar shërbimet publike përdoruesve të shërbimeve (*që në rastin konkret është të ndërtojë Teatrin e ri Kombëtar, që të përdoret nga artëdashësit*). Ndërkohë që ligji për prokurimet publike parashikon qartë se projekte të tilla mund të realizohen vetëm nëpërmjet një procedure "konkurs projektimi".

Më parë Kryeministri Edi Rama dhe më datë 18 Maj 2020 edhe Kryetari i Bashkisë Tiranë Erion Veliaj, prezantuan projektin fitues për Teatrin e ri Kombëtar. Ky projekt është përzgjedhje personale e Edi Ramës dhe Erion Veliajt, ndërkohë që sipas nenit 35 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, një projekt i tillë nuk

⁹ Shiko nenet 4, 5 dhe 8 të ligjit nr. 125/2013

¹⁰ Konkretisht, Fusha sh.p.k. ka rreth 290 m² të blerë në Mars 2016, nga rreth 1255 m² pronë private që përfshihen në projekt, apo 2100 m² që ka në pronësi Bashkia Tiranë, apo nga 8500 m² që parashikohet të jetë i gjithë zhvillimi i projektit.

mund të përzgjidhet veçse me një procedurë konkurimit "konkurs projektimi".

Të gjitha veprimet si më sipër, rezulton të jenë kryer për t'i hapur rrugë realizimit të projektit të përgatitur nga arkitekti z. Bjarke Ingels (puna për realizimin e të cilit sic pohon vetë ka nisur që në vitin 2016), që nga njëra anë deklaron se është ftuar për realizimin e projektit nga Kryeministri Edi Rama dhe Kryetari i Bashkisë Erion Veliaj, por ndërkohë prezanton zyrtarisht si klient që ka kontraktuar atë subjektin privat Fusha sh.p.k.

Nga ana tjetër, me VKM nr. 352, datë 04.04.2019, Këshilli Ministrave vendos ngritjen e Komisionit për Vlerësimin dhe Negocimin e Kontratës Realizimit e Projektit të Zhvillimit të Zonës së Teatrit Kombëtar si dhe përcakton Bashkinë Tiranë që të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshme për shpalljen e tenderit si dhe për zbatimin e projektit të zhvillimit të zonës përreth Teatrit Kombëtar.

Ka një mungesë informimi dhe transparence totale nga ana e Bashkisë Tiranë mbi procedurën konkurrese të ndjekur në këtë rast. Nuk është bërë publike as përbërja e Komisionit të Vlerësimit, as aplikimet e shoqërive tregtare apo negociatat me to. Deri në momentin që në datë 26.02.2020, përtej çdo afati të parashikuar në ligjin special, Erion Veliaj deklaron që Komisioni i ngritur dhe shoqëria që kishte garuar ("Fusha" sh.p.k.) nuk arrijnë dakordësinë dhe Bashkia Tiranë deklaron se Teatri do të ndërtohet me fonde publike.

Me anë të Vendimit nr. 377, datë **08.05.2020** të Këshillit të Ministrave "Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr. 1/241, me emërtimin "Teatri Kombëtar", në zonën kadastrale 8150, Tiranë" kjo pronë, në kundërshtim me dispozitat ligjore kaloi ne pronësi të Bashkisë Tiranë. Kjo bashki pavarësisht faktit se në territorin e saj ka truallin apo kishte dhe godinën e Teatrit Kombëtar, në bazë të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nuk ka asnjë kompetencë ligjore ne administrimin e një prone apo një institucioni kulturor me karakter kombëtar.

Në datën **13.05.2020**, Instituti i Ndërtimit i dërgon Bashkisë Tiranë shkresën me nr. 1026/1 e cila është administruar në këtë bashki në datën **13.05.2020** me Nr. 15121/1 Prot.. Ky institucion i kthen përgjigje kërkesës së Bashkisë Tiranë për të vlerësuar Teatrin Kombëtar.

Siç duket qartë, për vetëm një ditë pune, ky institucion në bashkëpunim me disa inxhinierë, arrin në konkluzionin që godina e Teatrit Kombëtar do të duhet të shembet pasi përben rrezik për sigurinë e qytetarëve. Siç referohet dhe në këtë ekspertim, inxhinierët që kanë sugjeruar një vendimmarrje të tillë janë bazuar në Aktin e Ekspertimit të kryer në muajin Mars 2018 dhe më konkretisht me shkresën me Nr. 75/1 Prot., datë 23.03.2018.

Nga të dy aktet e ekspertimit që janë kryer, rezulton që inxhinierët që kanë hartuar këto akte kanë konsumuar elementet e veprës penale të shpërdorimit të detyrës.

Së pari të gjithë këta shtetas nuk kanë shqyrtuar dhe nuk kanë analizuar dokumentacionin ligjor në lidhje me dokumentat e pronësisë të objektit pjesë e aktit të ekspertimit.

Së dyti, këta shtetas kanë analizuar në vitin 2018 vetëm godinën e Teatrit Kombëtar dhe në asnjë moment nuk kanë kryer ekspertim për Teatrin Eksperimental "Kujtim Spahivogli". Të gjitha konkluzionet e arritura nga grupi i inxhinierëve të Institutit të Ndërtimit janë vetëm për godinën e Teatrit Kombëtar ndërsa në asnjë moment këto konkluzione nuk i referohen Teatrit Eksperimental i cili ishte restauruar së fundmi.

Së treti, tre prej inxhinierëve që kanë nënshkruar Aktin e Ekspertimit të datës 13.05.2020 rezultojnë që nuk kanë qenë në asnjë moment në kryerjen e ekspertimit në ambientet e Teatrit Kombëtar, si për periudhën 11-13.05.2020 dhe po ashtu në muajin Mars 2018 kur është kryer edhe ekspertimi i parë. Pra, rezulton se inxhinierët që kanë arritur në një konkluzion kaq të rëndësishëm nuk kanë qenë për asnjë moment në inspektim për arritjen e një konkluzioni me anë të akteve të ekspertimit.

Së katërti, rezulton që në konkluzionet e këtij grupi ekspertësh nuk kemi vetëm një vendimmarrje për rrezikshmërinë e ndërtesës dhe për kushtet teknike të saj, por këta shtetas, krejtësisht jashtë detyrave të lëna apo kompetencave që i ngarkon ligji, i kanë rekomanduar Bashkisë të Tiranës që të ndërtojë një teatër tjetër! Në konkluzionet e tyre, këta shtetas të kallëzuar prej nesh, kanë dalë totalisht jashtë kompetencave të tyre në dhënien e një opinioni të pakërkuar.

Së pesti, në Aktin e Ekspertimit të datës 13.05.2020 inxhinierët e kallëzuar prej nesh, rekomandojnë që të pezullohet aktiviteti dhe ndalohet aksesimi në godinë për të parandaluar çdo dëmtim serioz për shëndetin e njerëzve. Ky akt i fundit ekspertimi ka qenë i bazuar në Aktin

e Ekspertimit të vitit 2018. Si ka mundësi që po të njëjtët persona që kryen ekspertimin në Mars të 2018 nuk konstatuan që kjo godinë përbënte rrezik serioz për shëndetin e qytetarëve dhe nëse po përse nuk e sugjeruan që në vitin 2018, por u kujtuan vetëm në vitin 2020?! Për më tepër, disa nga personat që kanë nënshkruar aktin rezultojnë të mos kenë asnjë ekspertizë në fushën e ndërtimit, sic kërkohet për ekspertët e fushës.

Një ditë pas kësaj shkrese të Institutit të Ndërtimit, Këshilli Bashkiak miratoi fshehurazi më **14 Maj 2020** shembjen e ndërtesës së Teatrit Kombëtar me anë të VKB nr. 50 datë 14.05.2020 për miratimin e shembjes së godinës të "Teatrit Kombëtar" pasuri në pronësi të Bashkisë Tiranë, bazuar në Akt Ekspertizën e hartuar nga Instituti i Ndërtimit "Mbi vlerësimin e Teatrit Kombëtar". Ky vendim i Këshillit Bashkiak përmban në vetvetë një sërë shkeljesh ligjore, për të cilat duhet të mbajë përgjegjësi penale kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj dhe kryetari i Këshillit Bashkiak Tiranë z. Toni Gogu.

Propozimi i bërë në Këshillin Bashkiak është kryer nga të kallëzuarit, me funksion drejtues të drejtorive të ndryshme në Bashkinë Tiranë, të cilët në shkelje flagrante, jashtë kompetencave të tyre funksionale, dhe kundërshtim me ligjin nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Gjithashtu personat e kallëzuar nga ana jonë janë në dijeni të plotë të faktit që nuk është kompetencë e Këshillit Bashkiak që të ndër marrë vendime të tilla.

Vendimi i Këshillit Bashkiak është i paligjshëm. Konkretisht:

- (i) Thirrja e mbledhjes së Këshillit Bashkiak bëhet jo më pak se 5 ditë para datë së zhvillimit të saj (neni 53 i ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"). Këshilli Bashkiak Tiranë ka lajmëruar thirrjen e mbledhjes në 13 Maj, ndërsa shtimi i pikës së rendit të ditës për shembjen e Teatrit është bërë në 14 Maj, në ditën e votimit.
- (ii) Mbledhja e Këshillit Bashkiak është e vlefshme kur në të marrin pjesë shumica e të gjithë anëtarëve, ndërsa në raste të caktuar kërkohet pjesëmarrja e shumicës së cilësuar (neni 53, pika 2 i ligjit Nr. 139/2015). Vendimet merren me tre të pestat kur Këshilli vendosur për tjetërsimin e pronave apo dhënien në përdorim të tyre (neni 55 i ligjit Nr. 139/2015). Këshilli Bashkiak Tiranë nuk ka zhvilluar mbledhje, e as verifikuar kuorumin, për rrjedhojë mbledhja është e pavlefshme.

- (iii) Të gjitha kompetencat e Këshillit Bashkiak janë parashikuar në nenin 54 të ligjit Nr. 139/2015. Në asnjë gjërmë, në asnjë pikë, në asnjë nen nuk parashikohet e drejta e Këshillit Bashkiak për të vendosur prishjen e një ndërtese. Këshilli Bashkiak ka vepruar në mungesë të kompetencës.
- (iv) Vendimi i Këshillit Bashkiak mbështetet në nenin 54, pika "e" që parashikon të drejtën për tjetërsim apo dhënie në përdorim të të tretëve vjen në kundërshtim me pikën 2 të Vendimi Nr. 377, datë 08.05.2020 të Këshillit të Ministrave që ndalon tjetërsimin apo dhënien në përdorim. Mosrespektimi i kufizimeve të vendosura në vendimin e qeverisë vjen në kundërshtim me nenet 7 dhe 8 i ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për tranferimin e pronave publike në pronësi të njësive vendore".
- (v) Vendimi i Këshillit Bashkiak vjen në kundërshtim me nenin 25, të cituar në vendim, i cili parashikon se Bashkia duhet të kujdeset për ruajtjen dhe promovimin e objekteve të trashëgimisë kulturore. Pra, Bashkia Tiranë e ruan dhe promovon trashëgiminë kulturore dhe nuk ka kompetencë për ta shkatërruar atë.
- (vi) Këshilli Kombëtar i Territorit është përgjegjës për dhënien e lejeve për prishjen e objekteve të rëndësisë kombëtare (neni 28 i ligjit Nr. 107/2014). Të drejtën ekskluzive për të vendosur prishjen/ndërtimin e një teatri kombëtar e ka Këshilli Kombëtar i Territorit (neni 19 i Rregullores për zhvillimin e territorit) dhe jo Këshilli Bashkiak i Tiranës. Leja e prishjes dhe një ndërtimi të ri jepen së bashku (neni 39 i ligjit Nr. 107/2014). Këshilli Bashkiak Tiranë ka përvetësuar një kompetencë që i përket ekskluzivisht Këshillit Kombëtar të Territorit.
- (vii) Neni 43 i ligjit Nr. 107/2014 dhe neni 15 i Rregullores parashikojnë një listë të gjatë me dokumentet e nevojshme për lejen e ndërtimit/prishjes. Kërkesa shqyrtohet fillimisht nga Sekretariati i Këshillit Kombëtar të Territorit, i cili nëse nuk vëren mangësi në dokumentacion ia kalon atë për shqyrtim KKT-së, brenda pesë ditëve. Vendimi për miratimin ose jo të lejes duhet të merret brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për leje ndërtimi, ndërsa leja e ndërtimit i vihet në dispozicion kërkuarit brenda 30 ditëve pas marrjes së vendimit. Ligji dhe rregullorja kanë parashikuar afate të tilla si domosdoshmëri për shqyrtimin e duhur të dokumenteve të paraqitura nga kërkuari. Por, vendimi i Këshillit Bashkiak Tiranë është marrë jo vetëm pa

kërkuar dhe shqyrtuar asnjë dokument teknik të detyrueshëm—në fakt Këshilli bashkiak as nuk ka ndonjë kompetencë që të shqyrtojë dokumente të tilla teknike—por, për pasojë në një mënyrë të menjëhershme.

- (viii) Neni 55, pika 6 e ligjit Nr. 139/2015 parashikon se vendimi i Këshillit Bashkiak hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij. Vendimi Nr. 50, datë 14.05.2020 u miratua në 14 Maj, ndërsa ndërtesa e Teatrit Kombëtar u prish në datën 17 Maj, në shkelje të vetë vendimit. Bashkia Tiranë, Inspektoriat i për Mbrojtjen e Territorit, Policia Bashkiake, Policia e Shtetit kanë vepruar në paligjshmëri të plotë, pasi vendimi nuk kishte hyrë në fuqi, pra ligjërisht nuk ekzistonte.

Drejtuesit e Drejtorive të Bashkisë Tiranë, në propozimin e tyre kanë kërkuar shëmbjen e godinës së Teatrit Kombëtar bazuar në Akt Ekspertimin e Institutit të Ndërtimit. Ata si dhe 60 anëtarët e Këshillit Bashkiak që kanë miratuar shëmbjen e Teatrit Kombëtar, kanë kryer shkelje ligjore pasi kanë miratuar shëmbjen e dy godinave:

1 – Godinën e Teatrit Eksperimental për të cilën nuk ekziston një Akt Ekspertize. Ekspertiza e Institutit të Ndërtimit është bërë në vitin 2018 dhe vetëm për Godinën e Teatrit Kombëtar

2 – Godinën e Teatrit Kombëtar, e cila në fakt, bazuar edhe në vërtetimin e ZRPP, bashkangjitur VKB 50, nuk ka qënë e pasqyruar në kartelën e pasurisë të cilës i referohet VKM-ja me nr.377, datë 8.5.2020 “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë”. Sic shihet fare qartë në pasurinë që VKM 377 i kalon në pronësi të Bashkisë së Tiranës janë vetëm 1126 m² Ndërtesë sipërfaqe që korespondon me Teatrin Eksperimental “Kujtim Spahivogli”.

Nëpunësit Ditjon Baboci, Frida Pashako, Taulant Tusha, Borjana Vrusho, Devis Agaraj, Enton Punavija, etj., në cilësinë e tyre si anëtar të Këshillit Teknik pranë Bashkisë Tiranë, kanë aprovuar lejen e prishjes, jashtë kompetencave të tyre ligjore. Sipas nenit 39 të ligjit Nr. 107/2012/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.

Në Vendimit nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, në nenin 19/1/f, përcaktohen Lejet e Ndërtimit për të cilat është përgjegjëse KKT-ja, për pasojë edhe lejet e prishjes. Konkretisht, llojet e zhvillimit komplekse për

vendimmarrjen e të cilave është përgjegjës Këshilli Kombëtar i Territorit, në bazë të nenit 28, të ligjit, janë: f) muzetë dhe teatrot kombëtarë, veprat monumentale me rëndësi kombëtare, objektet në zonat e mbrojtura. Për këtë shkak, leja e ndërtimit (prishjes) së godinës së Teatrit Kombëtar nuk mund të miratohej nga Këshilli Teknik i Bashkisë Tiranë, por duhet të ishte shqyrtuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Në këto kushte, anëtarët e Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë kanë kryer veprat penale të "Shpërdorimit të detyrës" dhe "Shkatërrimit të pronës të parashikuar nga nenet 248 dhe 150 të Kodit Penal pasi kanë kryer veprime aktive në kundërshtim me ligjin duke u shprehur mbi një leje ndërtimi (prishje), jashtë kompetencës së tyre ligjore dhe në kundërshtim me ligjin, duke sjell pasojën e rëndë të asgjësimit të ndërtesës historike të Teatrit Kombëtar.

Nga ana tjetër, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit ka shëmbur një objekt që nuk rezultonte i regjistruar, që nuk kishte një leje ndërtimi (prishje) nga organi kompetent sipas ligjit dhe për pasojë duhet të kishte ndjekur procedurat e parashikuara nga ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" dhe ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Sa më sipër, nga ana e drejtuesit të IMT-së me veprimet e veta aktive ka konsumuar veprat penale të "Shpërdorimit të detyrës" dhe "Shkatërrimit të pronës të parashikuar nga nenet 248 dhe 150 të Kodit Penal pasi ka kryer veprime aktive në kundërshtim me ligjin duke shëmbur godinën e Teatrit Kombëtar, për të cilën nuk kishte një vendim të ligjshëm prishje pasi objekti nuk ka figuruar si i regjistruar dhe KKT nuk kishte miratuar prishjen.

Legjislacioni aktual përcakton qartë që për mbrojtjen, restaurimin dhe vlerësimin e Qendrave Historike, monumenteve të kulturës, institucioni përgjegjës është Instituti i Monumenteve të Kulturës. Me anë të shkresës Nr. 758 Prot., datë 6.11.2014, Drejtori i Teatrit Kombëtar Hervin Culi i drejtohet IMK për nevojën e skanimit të situatës dhe rekomandim nga ana e IMK për vijimin e aktivitetit të TK. Grupi i inspektimit të IMK, rekomandon vetëm ndarjen e ambjenteve të dëmtuara nga ato të padëmtuara dhe rehabilitimin e pjesës së dëmtuar. Ky rekomandim i është dërguar edhe Drejtorit të TK z. Culi dhe për dijeni Ministres Kumbaro me anë të shkresës nr. Prot. 1747/1 dt 11.11.2014. Në vijim ka një korrespondencë të z. Culi me Ministrinë me anë të shkresës nr. Prot. 758/2 dt. 13.11.2014, ku i kërkon kësaj të fundit hartimin e preventivit për ndërhyrjet në pjesën e dëmtuar të skenës. Pas kësaj kërkesë, Këshilli Kombëtar t Restaurimeve, me anë të vendimit nr. 8, dt 8.1.2016 miraton projektin "Ndërhyrje emergjente në repartin e

zdruktharisë të Teatrit Kombëtar si dhe ngarkon Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e vendimit. Vendimi është Firmosur nga Ministrija Kumbrovo si Kryetare e KKR dhe Drejtoresha e IMK Arta Dollani si sekretare e KKR.

Nga kjo korrespondencë shihet qartë që Teatri Kombëtar ka qenë dhe është trajtuar gjithnjë me statusin Monument Kulture, pjesë e qendrës historike të Tiranës.

Së dyti, KKR ka miratuar projekt restaurimi të pjesshëm të TK. Pse janë harxhuar këto fonde në një kohë kur Teatri pretendohet që nuk kishte vlera dhe ishte tërësisht i amortizuar? A është ky një abuzim me fondet që i kushtojnë rëndë buxhetit të shtetit? Kush mban përgjegjësi për këto fonde të shpenzuara në një ndërtesë që më pas u nxorr jashtë funksioni me urdhër nga Drejtori Culi e më pas u shemb. Kush mban përgjegjësi për fondet e shpenzuara për restaurimin e Teatrit Eksperimental e që u shemb në datë 17 maj 2020?

Pra sic duket nga të gjitha dokumentacionet ligjore që disponohen për pronësinë e këtij objekti rezulton që personat e kallëzuar prej nesh dhe 60 anëtarët e Këshillit Bashkiak kanë kërkuar shembjen e një pasurie që nuk ka qenë asnjëherë pronë e Bashkisë Tirane si dhe të një godine për të cilën nuk kanë pasur asnjë akt ekspertize. Godinë e cila është restauruar tërësisht vetëm pak vite më parë dhe ishte në gjendje të mirë infrastrukturore.

Në datën 17.05.2020, në ora 04:30, në mënyrë të dhunshme, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai pranë Bashkisë Tirane, në zbatim të VKB-së me Nr. 50, datë 14.05.2020 shembi godinën e Teatrit Kombëtar (i cili nuk ishte në pronësi të Bashkisë Tirane) si dhe atë të Teatrit Eksperimental "Kujtim Spahivogli" (të cilin e kishte në pronësi), por për të cilin nuk kishte një akt ekspertimi ku të bazohej shembja.

Ky veprim i ndërmarre nga ana e IKMT është në kundërshtim të hapur me dispozitat ligjore pasi është marrë në zbatim të një vendimi i cili nuk kishte hyrë ende në fuqi dhe nuk kishte plotësuar afatet ligjore për të marrë fuqi ligjore dhe si i tillë i pazbatueshëm. Dhe në rast se ndërhyrja e IKMT-së është kryer si pasojë e kërkesës së ardhur nga IMT Bashkia Tirane përsëri ky institucion kishte të gjithë detyrimin ligjor që të vërtetonte dokumentacionin ligjor teknik si dhe ligjshmërinë e vendimmarrjes. Në këtë rast ky Inspektorat nuk duhet të vepronte mbi një vendim që nuk kishte hyrë ende në fuqi (dhe si i tillë ishte i

paekzekutueshëm) si dhe nuk mund të zbatonte një vendim të një organi që prishte një pronë publike që nuk e kishte në pronësi.

LIGJI I APLIKUESHËM:

Neni 280 i K.Pr.Penale

Marrja dijani për veprën penale

Prokurori dhe policia marrin dijani për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.

Neni 283 i K.Pr.Penale

Kallëzimi nga ana e shtetasve

1. Çdo person që ka marrë dijani për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.

2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit.

3. Kallëzimet anonime nuk mund të përdoren, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 194. Të dhënat e përmbajtjes së kallëzimit anonim mund të verifikohen nga prokurori ose policia gjyqësore për të siguruar elementë të provës, që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

Neni 75/a i K.Pr.Penale

Kompetencat e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjykon:

a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e;

b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;

c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;

ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 150 i K.Penal

Shkatërrimi i pronës

Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës, kur pasojat materiale nuk janë të lehta, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 154

Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera

Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës me mjete të tjera, që përbëjnë rrezik për mjedisin rrethues dhe jetën e njerëzve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Kur nga vepra penale kanë ardhur pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Kur janë shkaktuar pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 160

Shkatërrimi i veprave kulturore

Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i veprave kulturore dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Kur nga vepra penale janë shkatërruar apo dëmtuar vepra kulturore me rëndësi kombëtare, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy gjer në tetë vjet.

Neni 246

Përvetësimi i titullit apo i detyrës shtetërore

Përvetësimi i një titulli apo detyre shtetërore i shoqëruar me kryerjen e veprimeve që i takojnë mbajtësit të titullit apo të detyrës, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet. Kur vepra kryhet me qëllim fitimi apo ka prekur lirinë, dinjitetin apo të drejta të tjera themelore të shtetasit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 248

Shpërdorimi i detyrës

“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë

dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.

Neni 258

Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike

Kryerja nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik i veprimeve në kundërshtim me ligjet që rregullojnë lirinë e pjesëmarrjes dhe barazinë e shtetasve në tendera dhe ankande publike, për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Neni 259

Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.

Neni 260

Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet.

Nenet 8, 9 dhe 10 të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”:

Neni 8

Kompetenca lëndore parësore

“1. Kompetenca lëndore parësore e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar parashikohet në nenin 75/a të Kodit të Procedurës

Penale, por nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135, pika 2, të Kushtetutës.

2. Gjykata kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme janë kompetente për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër penale, sipas pikës 1, të këtij neni, edhe në rastet kur nuk ngrihet akuzë kundër një zyrtari, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, ose kundër një drejtuesi të një institucioni qendror ose të pavarur, sipas këtij ligji, ose nëse ai zyrtar publik ose zyrtar i lartë largohet gjatë kohëzgjatjes së hetimit”.

Neni 9

Kompetenca lëndore të tjera

“1. Gjykata kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme kanë kompetencë për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale brenda kompetencave të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji.

2. Prokuroria e Posaçme, në ushtrimin e ndjekjes penale, sipas parashikimeve të nenit 8, të këtij ligji, ka kompetencë për të kërkuar nga gjyqtarët e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.

3. Prokuroria e Posaçme, në ushtrimin e ndjekjes penale, sipas parashikimeve të nenit 8, të këtij ligji, ka kompetencë për të kërkuar zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

4. Gjykatat kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar kanë kompetenca mbi hetimet, çështjet dhe kërkesat e paraqitura në përputhje me këtë nen”.

Neni 10

Juridiksioni penal

“1. Gjykatat kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar e kanë vendndodhjen në Tiranë dhe e ushtrojnë juridiksionin e tyre penal në të gjithë territorin e Shqipërisë. Byroja Kombëtare e Hetimit mund të krijojë zyra të përkohshme ose të përhershme jashtë Tiranës, për të përmbushur qëllimin e saj.

2. Prokuroria e Posaçme ka juridiksion penal për hetimin dhe ndjekjen penale të çdo veprë të parashikuar nga nenet 8 dhe 9, të këtij ligji, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar

Ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"

Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar

Neni 17

Mbledhjet e këshillit të bashkisë

- 1. Mbledhjet e këshillit të bashkisë janë të hapura për publikun. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.*
- 2. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.*
- 3. Me kërkesën e kryetarit të bashkisë ose të një të pestës së anëtarëve të këshillit bashkiak, mbledhjet e këshillit bashkiak mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar jo më pak se tre të pestat e gjithë anëtarëve të tij.*

Neni 25

Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

- 1. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.*
- 2. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.*
- 3. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e bibliotekave e të ambienteve për lexim, me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve.*
- 4. Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.*

Neni 54

Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

- a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren*

- e brendshme të funksionimit të vet;*
- b) zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata;*
- c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit bashkiak;*
- ç) miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;*
- d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;*
- dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;*
- e) miraton tjetërsimin e pronave të tretëve;**
- e/1) miraton dhënien në përdorim të pronave të tretëve ose dhënien për zhvillim të pronës nëpërmjet bashkëpunimit me subjekte private.**
- ë) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të bashkisë;*
- f) vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;*
- g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;*
- gj) vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë;*
- h) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;*
- i) zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre, duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar;*
- j) vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 49 të këtij ligji;*
- k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;*
- l) vendos për simbolet e bashkisë;*
- ll) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë;*
- m) jep tituj nderi dhe stimuj;*
- n) vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit, me të cilin bëhet ky delegim te bashkia.*

Neni 55

Votimi

1. Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli, me kërkesë të jo më pak se 1/3 të anëtarëve të tij, vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Votimi i buxhetit dhe i akteve të tjera financiare që kanë lidhje me të bëhet kurdoherë i hapur.
2. Vendimet e këshillit merren me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rastit kur ky ligj parashikon ndryshe.
3. Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat "a", "b", "c", "d", "e/1", "dh", "f", "g", "gj", "i" dhe "j", të nenit 54, të këtij ligji.
4. Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën "e", të nenit 54, të këtij ligji.
5. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendës-kryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave. Në këtë rast fitues shpallet kandidati që ka numrin më madh të votave dhe, nëse votat janë të barabarta, fituesi caktohet me short.
- 6. Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.**

Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar

Neni 35

Konkurs projektimi

Autoriteti kontraktor mund të organizojë konkursin e projektimit, si pjesë e një procedure që çon në përzgjedhjen e kontratës fituese, për një plan apo projekt të zgjedhur nga një juri, mbi bazën e një procedure konkurrimi, kryesisht në fushën e planifikimit urban, rural, arkitektonik, inxhinierik etj.¹¹

Procedura konkurs projektimi mund të organizohet:

- a) si pjesë e një procedure, që shërben për përcaktimin e një fituesi të një kontrate shërbimi publik;*

b) për përfitimin vetëm të projektit kundrejt çmimit¹².

Autoriteti kontraktor që ndërmerr një konkurs projektimi, njofton qëllimin e prokurimit me anë të botimit të njoftimit për pjesëmarrje në konkurs, në përputhje me nenin 38 të këtij ligji. Njoftimi duhet të përmbajë informacionin e parashikuar në nenin 39 të këtij ligji.

Procedurat e hollësishme të organizimit për të dyja format e konkursit të projektimit, sipas pikës 2 të këtij neni, parashikohen në rregullat e prokurimit.

Rregullat e konkursit u komunikohen të gjithë të interesuarve, që kërkojnë të marrin pjesë në të. Pjesëmarrja në konkurs mund të kufizohet në një numër kandidatësh të përzgjedhur, në bazë të kriterëve të qarta dhe jodiskriminuese, që u janë bërë të njohura të gjithë personave të interesuar, me kusht që numri i kandidatëve të ftuar, sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit, të jetë i mjaftueshëm për të siguruar një konkurrim të drejtë.

Pranimi i pjesëmarrjes në konkurs nuk mund të kufizohet:

- c) për shkak të shtetësisë, territorit apo rezidencës;*
- d) për shkak të qenies person fizik ose juridik.*

Komisioni krijohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në rregullat e prokurimit. Ai përbëhet nga persona, që nuk kanë konflikt interesash me pjesëmarrësit në konkurs dhe merr vendime në mënyrë të pavarur, në bazë të kriterëve të përcaktuara në njoftimin për konkurs, duke respektuar parimin e fshehtësisë.

VENDIM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

Neni 38

Konkursi i projektimit

- 1. Konkursi i projektimit është një procedurë prokurimi me faza, sipas nenit 35 të LPP, nëpërmjet së cilës autoriteti kontraktor përzgjedh një studim ose projekt, që ka vetëm natyrë estetike.*

¹² Fjalët "kundrejt shpërblimit monetar" janë zëvendësuar me fjalët "kundrejt çmimit", me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

2. *Konkursi i projektimi mund të organizohet si pjesë e një procedure, që shërben për përcaktimin e një fituesi të një kontrate shërbimi publik ose vetëm për përfitimin e një projekti.*
 - a) *Në rastin kur autoriteti kontraktor organizon një konkurs projektimi, ku objekti është një projektide, në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohen qartë kriteret e vlerësimit teknik, çmimi dhe/ose rimbursimet që jepen për kandidatin fitues dhe për kandidatët e tjerë të pranuar.*
 - b) *Në rastin kur autoriteti kontraktor organizon konkurs projektimi, si pjesë të një procedure që çon në përzgjedhjen e kontratës fituese për shërbime, mund të përdorë procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit për kryerjen e shërbimit me kandidatin e suksesshëm të dalë në përfundim të konkursit të projektimit.*
 - c) *Në çdo rast, në dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor duhet të bëjë të njohur qëllimin e tij për të marrë vetëm një projektide apo për të marrë projektide dhe shërbimin në lidhje me këtë projektide.*
 - ç) *Përveç kriterëve përjashtuese, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së, autoriteti kontraktor duhet të përjashtojë ata kandidatë që janë punonjës të tij.*
3. *Hapat e procedurës së konkursit të projektimit janë:*
 - a) *Titullari i autoritetit kontraktor apo personi i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit, me të njëjtën përmbajtje si urdhri i përmendur në nenin 60 të këtyre rregullave. Për këtë lloj procedure prokurimi, urdhri i prokurimit nuk përmban fondin limit.*
 - b) *Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen e internetit të APP-së, në përputhje me LPP dhe me këto rregulla.*
 - c) *Afati kohor për dorëzimin e kërkesave për shprehjen e interesit, i përcaktuar në nenin 43 të LPP, është, si vijon:*
 - *Në procedurën e kërkesës për projektim, me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, afati minimal kohor për dorëzimin e kërkesës për shprehje interesi është 20 (njëzet) ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të APP-së;*
 - *Në procedurën e kërkesës për projektim, me vlerë ndërmjet kufirit të lartë e të ulët monetar, afati minimal kohor për dorëzimin e kërkesës për shprehje interesi është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të APP-së.*

Kur njoftimet janë hartuar dhe publikuar me mjete elektronike, në përputhje me formatin dhe procedurat për transmetim elektronik, të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik, afatet kohore të parashikuara në këtë shkronjë mund të shkurtohen 5 (pesë) ditë.

- c) Autoriteti kontraktor shqyrton kualifikimet e kandidatëve që kanë shprehur interes në bazë të kriterëve për kualifikim, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e hapjes së procedurës. Në përfundim të kësaj faze, kandidatët e kualifikuar përshihen në një listë të shkurtër, e cila duhet të përmbajë të paktën 2 (dy) kandidatë.
- d) Pas mbylljes së fazës së kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti kontraktor fton me shkrim kandidatët e përcaktuar në listën e shkurtër për paraqitjen e propozimeve të tyre. Ftesa përfshin qëllimin e autoritetit kontraktor, adresën, datën dhe orën e përcaktuar për dorëzimin e propozimeve.
Ftesa shoqërohet me udhëzimet e nevojshme për ofertuesit, ku jepet i gjithë informacioni që do t'i ndihmonte për përgatitjen e propozimeve, për procesin e vlerësimit dhe formularin e sigurimit të ofertës (nëse kërkohet).
- dh) Autoriteti kontraktor përcakton një afat kohor për dorëzimin e propozimeve, që u jep ofertuesve kohë të mjaftueshme për të përgatitur propozimet e tyre.
Afati kohor për dorëzimin e propozimeve, i parashikuar në nenin 43 të LPP, është, si vijon:
- Në procedurën e konkursit të projektimit, me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, afati minimal kohor për dorëzimin e ofertës është 20 (njëzet) ditë nga data në të cilën është dërguar ftesa për ofertë të kandidatët;
 - Në procedurën e konkursit të projektimit, me vlerë ndërmjet kufirit të lartë e të ulët monetar, afati minimal kohor për dorëzimin e ofertës është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data në të cilën është dërguar te kandidatët ftesa për ofertë.
- Gjatë kësaj kohe, ofertuesit mund të kërkojnë sqarime për informacionet e dhëna në kërkesën për propozime. Autoriteti kontraktor i jep këto sqarime me shkrim dhe ua dërgon të gjithë kandidatëve të përcaktuar në listën e shkurtër. Nëse është e nevojshme, zgjat edhe afatet kohore për dorëzimin e propozimeve. Pas mbarimit të afateve kohore për dorëzim nuk duhet të pranohet asnjë ndryshim i propozimeve. Zarfet, që përmbajnë propozimet, hapen menjëherë pas mbarimit të afatit për dorëzimin e propozimeve. Çdo zarf që merret pas mbarimit të afatit, kthehet i pahapur.
- e) Vlerësimi i propozimeve kryhet brenda 20 (njëzet) ditëve nga afati i përfundimtar i përcaktuar për hapjen e tyre dhe u komunikohet ofertuesve pjesëmarrës. Ky proces regjistrohet nëpërmjet procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim.

4. *Komisioni i vlerësimit duhet të përbëhet nga një numër tek anëtarësh (zakonisht shtatë), pjesëtarë ose jo të autoritetit kontraktor dhe ku shumica duhet të kenë të njëjtën licencë ose specializim të përcaktuar në kërkesat për kualifikim të kandidatëve në dokumentet e tenderit, si dhe një përvojë 10 vjeçare në çështjet e projektit që do të prokurohet.*

VENDIM Nr. 686, datë 22.11.2017 "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT"

Neni 30

Çështjet, zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare në planifikim

1. *Çështjet, zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare në planifikim janë subjekt i planifikimit kombëtar.*
2. *Çështjet, zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare karakterizohen nga vlera të veçanta kulturore, historike, ekonomike, sociale ose mjedisore të një apo disa strukturave, instalimeve, rrjeteve ose zonave, që synojnë drejtpërdrejt realizimin e interesave kombëtarë në pjesë të territorit, si:*
 - a) monumentet e kulturës, qendrat historike, zonat e parqet arkeologjike;**
 - b) *pyjet e zonat e mbrojtura natyrore, monumentet natyrore, rrjetet ekologjike, ekosistemet e rrezikuara dhe biodiversiteti;*
 - c) *brezi bregdetar, brigjet dhe burimet ujore, lagunat, lumenjtë, liqenet;*
 - ç) *toka bujqësore;*
 - d) *zonat me rrezik natyror;*
 - dh) *digat e dambat;*
 - e) *burimet minerare e natyrore dhe rrjetet, komplekset e parqet industriale;*
 - ë) *infrastruktura kombëtare e transportit;*
 - f) *infrastrukturat inxhinierike të energjisë dhe telekomunikacionit;*
 - g) *zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit;*
 - gj) *zonat ushtarake;*
 - h) zhvillime ose struktura arsimore, shëndetësore, sociale, kulturore e artistike, sportive, të cilat, për shkak të veçorive të tyre, janë të rëndësishme për kryerjen e veprimtarisë së institucioneve shtetërore, sikurse përcaktohet me ligj.**
3. *Çështjet, zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare përfshijnë ato të shpallura me Vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas legjislacionit sektorial në fuqi për mjedisin, kulturën, ekonominë, turizmin, infrastrukturën, planifikimin / zhvillimin urban, etj.*

Neni 31

Përcaktimi i çështjes, zonës dhe objektit të rëndësisë kombëtare

1. Agjencia, kryesisht ose me kërkesë të një ministrie apo të një organi tjetër qendror ose vendor, ndërmerr nismën dhe i propozon për miratim KKT-së përcaktimin e një çështjeje, zone ose objekti si të rëndësisë kombëtare në planifikim.
2. Çështjet, zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare propozohen edhe gjatë procesit të hartimit të Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit dhe planeve kombëtare sektoriale
3. KKT-ja miraton një çështje, zonë apo objekt si të rëndësisë kombëtare, si pjesë e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit, planeve kombëtare sektoriale, ose përmes një procesi të veçantë me propozim të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.
4. Kur miratimi sipas pikës 3, të këtij neni, kryhet përmes një procesi të veçantë, projektakti për miratimin e nismës përmban:
 - a) llojin dhe veçoritë e çështjes, të zonës ose objektit të rëndësisë kombëtare;
 - b) kufijtë apo vendndodhjen në territor, sipas rastit;
 - c) referencën në legjislacionin e posaçëm dhe/ose në dokumentet e planifikimit në fuqi ku mbështetet nevoja për përcaktimin e rëndësisë kombëtare;
 - ç) objektivat që kërkohen të arrihen dhe arsyet e rrethanat ekonomike e teknike që e bëjnë të domosdoshëm këtë përcaktim;
 - d) propozimin për pezullimin e zhvillimit, sipas ligjit, nëse është i nevojshëm;
 - dh) përcaktimin e detyrimit për hartimin e Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare, sipas rastit;
 - e) përcaktimin e autoritetit përgjegjës për hartimin e Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare, sipas rastit.
 - f) përcaktimin e detyrimit për hartimin e Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare, sipas rastit;
5. Vendimi i KKT-së së bashku me dokumentacionin e plotë shoqëruar botohen në regjistër dhe, në çdo rast, në faqen zyrtare të sekretariatit të KKT-së, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit, në përputhje me pikën 4, të nenit 56, të ligjit.
6. Kur në planet kombëtare apo në vendimin e KKT-së përcaktohet detyrimi për hartimin e Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare, autoriteti përgjegjës për çështjen duhet të ndërmarrë hapat për hartimin e tij.
7. Struktura dhe forma, si dhe procesi për nismën, hartimin dhe miratimin e Planit të Detajuar për një Zonë të Rëndësisë Kombëtare përcaktohen në këtë rregullore, ndërsa zbatimi i PDZRK-së nëpërmjet instrumenteve të

zhvillimit dhe lejeve të ndërtimit përcaktohen në rregulloren e zhvillimit sipas përcaktimeve të pikës 5, neni 18, të ligjit.

ANALIZA LIGJORE:

Është shumë e rëndësishme jo vetëm për ne, por edhe për çdo qytetar të këtij vendi, që të bëjë ai vetë kallëzimin penal që nga momenti që vihet në dijeni të kryerjes së një vepre penale, aq me shumë kur ajo konsumohet nga subjekte të cilat kanë si prerogativë mbizotërimin e ligjit dhe duhet të garantojnë ndëshkueshmërinë e dhunuesve. I takon organeve të prokurorisë më pas marrja e të gjitha masave për vënien para drejtësisë dhe dënimin e autorëve, pavarësisht funksioneve të tyre apo pozitës që gëzojnë.

Sipas dispozitës ligjore penale që përcakton veprën penale të shpërdorimit të detyrës, që të ekzistojë vepra penale duhet që të vërtetohet cënimi i rregullave të vendosura nga aktet ligjore ose nënligjore që normojnë detyrat e punonjësit shtetëror apo të personit që ushtron detyra apo funksione publike.

Në rastin konkret, vërtetohet cënimi i rregullave të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore për sa i përket procedurave të ndjekura në lidhje me kalimin e pronësisë të truallit të Teatrit Kombëtar dhe shembjen e godinave të Teatrit Kombëtar dhe Teatrit Eksperimental.

Të gjithë personat e kallëzuar nga ana jonë kanë konsumuar elementet e vepres penale sipas parashikimeve të Kodit Penal dhe përmbushin të gjitha kushtet ligjore për të mbajtur përgjegjësi penale.

Në kushte të tilla, personat e mesipër kanë kryer veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin, të cilat sjellin si pasojë mospërmbushje të rregullt të detyrës, duke shkelur në mënyre flagrante, në bashkëpunim në formën e organizatës kriminale.

Për çdo person do të përmendim shkeljet ligjore që secili prej tyre ka konsumuar pasi për persona të ndryshëm ka konsumim të veprave të vecanta penale të përmendura më sipër. Të vecantë këtë situatë e bën koordinimi i kryerjes së të gjithë këtyre veprave penale nga persona të ndryshëm, por që të gjitha janë bërë me një qëllim, atë të përfitimit financiar dhe shembjen e një objekti me rendësi të veçantë kulturore në lidhje me identitetin kombëtar.

Personi i parë i kallëzuar prej nesh është Edi Rama me detyrë Kryeministër i Republikës së Shqipërisë. Ky person me veprime konkrete ka konsumuar elementët e vepres penale të parashikuara nga neni 248 i K.Penal. Ky person në mënyrë të paligjshme ka kryer veprime që bien në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" ku ky shtetas me funksion Kryeministër është në dijeni të faktit që një ndërtesë më rendësi kombëtare nuk mund t'i kalojë në pronësi një njesie vendore, por organi i vetëm që mund të vendosë për të është KKT e cila drejtohet nga ky shtetas *ex officio*. Gjithashtu ky shtetas ka qenë në dijeni të plotë të faktit që ka shkelur ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, ku në mënyrë abuzive, pa respektuar asnjë procedurë prokurimi publik, ai së bashku me të kallëzuarin tjetër Erion Veliaj, përzgjedhin një person për kryerjen e një projekti publik në mënyrë arbitrare dhe të kundërligjshme. Duke vepruar në këtë mënyrë ky shtetas ka konsumuar elementët e vepres penale të përcaktuar nga neni 258 i Kodit Penal "Shkelja e barazise së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike". Këtë vepër e ka kryer në funksion të Organizatës Kriminale dhe si drejtues i saj, si dhe në bashkëpunim me shtetasin Erjon Veliaj pasi të dy këta shtetas kanë përcaktuar që prej vitit 2016 projektuesin e Teatrit të Ri Kombëtar si dhe prishjen e Teatrit Kombëtar. Kjo vepër është provuar që është konsumuar pasi ka qenë vetë Arkitekti Bjark Ingels i cili e pranon faktin që ai ka qenë i përzgjedhuri i këtyre 2 personave të kallëzuar për të projektuar Teatrin e ri Kombëtar. Gjithashtu këta dy shtetas në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë kryer të gjitha veprimet që prej 2016 që të shembnin Teatrin Kombëtar dhe të ndërtonin një të ri me një sipërfaqe shumë më të vogël ndërtimi dhe në këtë mënyrë mund të shfrytëzonin pjesën e mbetur të truallit të teatrit Kombëtar e të pronës publike pas tij (gjithsej 8467 m² toke publike) për të ngritur ndërtesa të larta mbi 20 kate mu në zemër të Tiranës, në pjesën më të rëndësishme e historike të saj, pasi pozicioni i vendodhjes së tij është nga më të favorshmit në Tiranë.

Shtetasi Erion Veliaj gjithashtu ka kryer veprat penale të "Shkatërrimit të pronës me mjete të tjera", parashikuar nga neni 150 i K.Penal, "Shkatërrimit të veprave kulturore", parashikuar nga neni 154 i K.Penal, "Shpërdorimit të detyrës", parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Së pari, ky shtetas, në bashkëpunim me vartësit e tij të cilët janë gjithashtu të kallëzuar, ka ndërmarrë veprime konkrete për kryerjen e veprave penale të sipërpërmendura. Shtetasi Erion Veliaj ka kryer veprime konkrete për të shembur një objekt të cilin nuk e kishte në pronësi Bashkia Tiranë pasi siç rezulton nga dokumentacioni tekniko ligjor, Bashkia e Tiranës është pronare e vetëm një sipërfaqeje objekti prej 1126 m², sipërfaqe e cila

korrespondon me gjurmën e ndërtimit të godinës së Teatrit Eksperimental "Spahivogli" ndërsa pjesa tjetër e sipërfaqes së objektit nuk i është transferuar në pronësi Bashkisë së Tiranës nga Këshilli i Ministrave. Fakti tjetër që është dhe më i rëndë është ai që institucioni i Bashkisë Tiranë që përfaqësohet nga kryetari i saj, në momentin që i ka kërkuar Këshillit Bashkiak marrjen e një vendimi për shembjen e godinës së TK, i është referuar një Akti Ekspertimi i cili ka analizuar vetëm godinën e TK ndërsa në asnjë momen ky ekspertim nuk pasqyron gjetje në lidhje me godinën që zhvillonte aktivitetin TE (Teatri Eksperimental) "Spahivogli". Gjithashtu, shtetasi Erion Veliaj, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, në bashkëpunim me vartësit e tij, në funksion të organizatës kriminale, kanë kërkuar vendimmarrjen e një organi i cili nuk e ka pasur në kompetencë funksionale të tij shembjen e godinave të TK dhe TE. Pavarësisht se i kallëzuar Erjon Veliaj është i bindur që ky organ kolegjal nuk ka asnjë kompetencë për marrjen e vendimeve të tilla ai përsëri kërkon që ti shmangët përgjegjësisë penale duke deleguar një detyrë funksionale të tij te këshill. Gjithashtu shtetasi Erion Veliaj, në bashkëpunim me vartësit e tij të cilët janë gjithashtu subjekt i këtij kallëzimi, kanë ekzekutuar një vendim të Këshillit Bashkiak i cili nuk kishte marrë ende fuqi ligjore pasi në bazë të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, në zbatim të nenit 55 të tij, VKB-ja me numër 50, datë 14.05.2020, do të duhet të hynte në fuqi vetëm mbas datës 24.05.2020 ndërkohë që TK u prish në datën 17.05.2020. Këta shtetas, në bashkëpunim me njëri tjetrin, kanë konsumuar elementët e veprës penale duke ndërmarre veprime konkrete dhe duke i bazuar ato te një akt administrativ që akoma nuk kishte marrë fuqi ligjore. Nga ana tjetër, Erion Veliaj ka prezantuar projektin fitues të Teatrit të ri Kombëtar, në kundërshtim me nenin 35 të ligjit për prokurimet publike.

I kallëzuar tjetër prej nesh, shtetasi Toni Gogu, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Bashkiak Tiranë, ka konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal, "Shpërdorimi i detyrës". Ky shtetas pavarësisht procedurës së ndjekur për futjen në rend ditë të një çështjeje kaq sensitive si dhe faktit që ka marrë një kërkesë të tillë nga persona që nuk janë të legjitimuar nga ligji, duke qenë në dijeni të faktit që Këshilli Bashkiak nuk ka asnjë kompetencë ligjore që të ndermarrë një veprim të tillë për një pronë me karakter kombëtar, ka shkelur dispozitat ligjore me procedurën për thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak si dhe ka shmangur respektimin e afateve të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar. Dëshmia e të vetmit anëtar të Këshillit Bashkiak jo përfaqësues i PS vërteton që z. Gogu, pavarësisht se ligji e përcakton ndryshe, nuk e ka mbledhur asnjëherë këshillin Bashkiak, nuk ka alejuar të ketë diskutime për një nga çështjet më të debatuar për

qytetarët e Tiranës por jo vetëm, nuk është e qartë si është marrë vendimi në mungesë të një mbledhje që ishte thirrur një ditë më vonë.

Person tjetër i kallëzuar nga ana jonë është dhe shtetasja Dallëndyshe Bici dhe shtetasi Mariglen Qato, të cilët kanë konsumuar të gjitha elementet e veprave penale të "Shkatërrimit të pronës" parashikuar nga neni 150 i K.Penal, "Shkatërrimit të pronës me mjete të tjera" parashikuar nga neni 154 i K.Penal, "Shkatërrimit të veprave kulturore" parashikuar nga neni 160 i K.Penal dhe "Shpërdorimit të detyrës" parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Kryeinspektorja Bici dhe drejtori Qato kanë ekzekutuar një vendim të Këshillit Bashkiak i cili nuk ka qenë në fuqi ligjore dhe si i tillë nuk mund të ekzekutohej. Gjithashtu këta shtetasë nuk kanë administruar dokumentacionin ligjor teknik në lidhje me objektet që do të shembeshin pasi rezulton që është shembur një godinë e cila nuk ka qenë në pronësi të Bashkisë së Tiranës dhe si e tillë në çdo rast VKB-ja me Nr. 50 nuk mund të kishte fuqi ligjore mbi godinën e TK, por vetëm mbi TE "Spahivogli" sipërfaqia e të cilit korrespondonte me atë të kartelës së pasurisë. Nga ana tjetër nuk ka patur një leje ndërtimi (prishje) nga KKT, që të mundësonte veprimin nga IMT.

Shtetasit e tjerë të kallëzuar nga ana jonë janë dhe inxhinierët që kanë nënshkruar aktin e ekspertimit duke këshilluar shembjen e TK si një godinë e rrezikshme për shëndetin e personave dhe që mund të sillte pasoja shumë të rënda. Në aktin e ekspertimit të datës 13.05.2020, së paku 3 prej këtyre inxhinierëve, nuk kanë qenë në objekt që të kryenin një ekspertim dhe studimi shkencor që të arrinin në një konkluzion përfundimtar. Së dyti, këta shtetas, në mënyrë krejtësisht të paligjshme, i janë referuar një raporti të vitit 2018 i cili nuk sugjeronte që objekti të shembet apo që mund të sjelli pasoja shumë të rënda dhe të parikuperueshme për shëndetin e njerëzve. Këta persona jo vetëm që kanë konsumuar elementët e veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës" parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Tre inxhinierët që nuk kanë qenë pjesë e aktit ekspertimit të parë, pas asnjë prezencë në Teatrin Kombëtar, pa bërë asnjë matje, asnjë vizitë erdhën në konkluzionin që godina duhej demoluar, konkluzion që grupi i IN i vitit 2018 nuk e kishte kërkuar. Gjithashtu, duke vepruar në këtë mënyrë kanë rrezikuar jetën e qytetarëve. Këta shtetas, me arsim në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, në momentin që kanë kryer ekspertimin në vitin 2018 nuk konstatuan elemente rrezikshmërie që të kërkonin shembjen e kësaj strukture, ndërsa në vitin 2020 *apriori* hartuan një akt ekspertimi i cili është bazuar mbi ekspertimin e vitit 2018 në të cilin kërkonin shembjen e këtij objekti. Çfarë ndryshoi në 2 vite pasi faktet janë të njëjta dhe të 2 aktet e ekspertimit janë bazuar në inspektimin e kryer nga disa nga këta inxhinierë në vitin 2018. Këta shtetas nuk japin vetëm një opinion teknik,

por dhe atë opinion që japin nuk e bazojnë në të gjitha informacionet e mundshme. Përpara së këta inxhinierë të këshillonin shembjen do të duhet që të marrin informacion dhe nga Instituti i Monumenteve që të konfirmonin më parë a ka vlera historike apo jo një strukturë e tillë. Siç rezultoi në ekspertimin e kryer në vitin 2018, këta eksperte kanë arritur në konkluzionin që kjo godinë mund të restaurohet. Çfarë ndryshoi ndërkohë në opinionin e ekspertëve për një periudhë 2 vjeçare!?

Gjithashtu është për t'u theksuar fakti se leja për prishje në vetvete është një akt i paligjshëm bazuar në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar ku në pikën 1 të nenit 39 të tij parashikohet se "*Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji*" dhe në VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" e ndryshuar e cila në shkronjën "ç" të nenit 11 të saj parashikon se "*Punimet, për të cilat kërkohet pajisja me leje ndërtimi, sipas nenit 39, të ligjit, janë ato që: ... ç) kanë si pasojë prishjen e objekteve, në rast se prishja nuk shoqërohet me ndërtim të ri. Nëse prishja shoqërohet me ndërtim të ri, leja për prishje është pjesë e lejes së ndërtimit dhe shënohet në kushtet e dokumentit të lejes*".

Në këto kushte, për aq kohë sa si në vendimin e Këshillit të Ministrave për transferimin e pronësisë së truallit të Teatrit Kombëtar, por dhe në deklarimet publike të të kallëzuarve rezultoi se prishja e godinës së TK do të shoqërohet me ndërtimin e një godine të re të Teatrit Kombëtar atëherë do të duhej që prishja e godinës ekzistuese të ishte pjesë e lejes së ndërtimit për ndërtimin e godinës së re. E gjithë kjo situatë tregon se nxitimi për prishjen e godinës ekzistuese të TK është një veprim krejtësisht i paligjshëm.

Po kështu, siç e kemi parashtruar edhe me sipër, rezultoi qartë se personat e kallëzuar nuk kanë respektuar kuadrin ligjor në fuqi dhe i kanë konsumuar veprat penale në funksion të organizatës kriminale, të cilët në bashkëpunim kanë kryer një sërë veprash penale si "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë" parashikuar nga neni 260 i K.Penal, "organizata kriminale" e parashikuar nga neni 333 i K.Penal, "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal" parashikuar nga neni 334 i Kodit Penal. Këto vepra i kanë kryer me qëllimin e vetëm të përfitimit financiar dhe të pasurimit të kësaj strukture kriminale. Këta shtetas kanë vepruar në bazë të hierarkisë dhe të organizimit kriminal me qëllimin e vetëm për arritjen e përfitimeve.

Jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë ka arritur në një qëndrim të konsoliduar lidhur me elementët që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, në mënyrë që një person të ngarkohet me përgjegjësi penale. Përkatësisht, në mënyrë që të ndodhemi përpara një veprë penale duhet të bashkëekzistojnë katër elementë të veprës penale: objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive.¹³ Në vijim, do të analizojmë në mënyrë të detajuar secilin prej këtyre elementëve, të cilët në tërësinë e tyre provojnë se nga ana e kryeministrit të Shqipërisë, z. Edi Rama, kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, kryetarit të Këshillit Bashkiak Tiranë, z. Toni Gogu, drejtores së Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, znj. Dallëndyshe Bici, drejtorit të Institutit të Ndërtimit, z. Agron Hysenlliu, dhe nëpunësve në varësi të tyre, janë konsumuar të katër elementët e veprave penale të "Shkatërrimi i pronës" parashikuar nga neni 150 i K.Penal, "Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera" parashikuar nga neni 154 i K.Penal, "Shkatërrimi i veprave kulturore" parashikuar nga neni 160 i K.Penal, "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i K.Penal, "Shkelja e barazise se pjesëmarrësve ne tendera apo ankande publike", parashikuar nga neni 258 i K.Penal, "Korrupsioni pasiv i personave qe ushtrojnë funksione publike" parashikuar nga neni 259 i K.Penal, "Korrupsioni pasiv i funksionareve te lartë shtetërorë ose i te zgjedhurve vendore", parashikuar nga neni 260 i K.Penal, "Organizata kriminale" parashikuar nga neni 333 i K.Penal dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga neni 334 i K.Penal.

A. Vepra penale e "Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike":

Objekti: Objekti i veprës penale ka të bëjë me marrëdhënien juridike ose vlerën e rëndësishme shoqërore që legjislatori ka synuar të mbrojë posacërisht, duke vendosur sanksion penal në rast të shkeljes së saj. Në rastin e veprës penale të "Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", legjislatori ka synuar të mbrojë interesat ekonomike të shtetit dhe personave juridikë, të cilët dëmtohen rëndë si rezultat i favorizimit të një subjekti në dëm të një subjekti tjetër, në shkelje të parimeve të konkurrencës së lirë dhe mosdiskriminimit. Në rastin konkret, si rezultat i shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në projektin për ndërtimin e Teatrit të ri Kombëtar nga Këshilli i Ministrave dhe Bashkia Tiranë, me titullarë shtetasit Edi Rama dhe Erion Veliaj, me qëllim favorizimin e kompanisë "Fusha" sh.p.k., dhe subjektit privat

¹³ *Vendimi Nr. 4, datë 15.04.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;*
Vendimi Nr. 3, datë 02.11.2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;

“BIG-BJARKE INGELS GROUP” dhe shtetasit Bjarke Ingels, me funksion arkitekt dhe partner i studios arkitekture, shteti shqiptar nuk ka marrë në shqyrtim oferta të tjera, të cilat mund të ishin më të leverdisshme për interesat e tij ekonomikë. Nga ana tjetër, ky favorizim i hapur ka dëmtuar edhe interesat e ligjshëm të kompanive të tjera, të cilat mund të kishin pasur interes për të marrë pjesë në një procedurë të rregullt tenderimi.

Ana objektive: Ana objektive e veprës penale ka të bëjë me veprimeve ose mosveprimet e kundërligjshme nëpërmjet të cilave është cënuar marrëdhënia juridike ose vlera shoqërore, e mbrojtur posacërisht nga legjislacioni penal. Në rastin e veprës penale të “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, ajo kryhet nëpërmjet veprimeve aktive. Nëpërmjet këtyre veprimeve të paligjshme preket pozita e barabartë e një operatori ekonomik me qëllim favorizimin në mënyrë të paligjshme të operatorëve të tjerë. Qeveria shqiptare dhe Bashkia Tiranë kanë kryer në mënyrë të përsëritur veprime aktive me qëllim favorizimin e një subjekti të vetëm, duke cënuar pozitën e të gjithë operatorëve të tjerë.

Kështu, fillimisht, u përcaktua nga Edi Rama dhe Erion Veliaj projekti i Teatrit Kombëtar, dizenuar nga arkitekti danez Bjarke Ingels, mik i tij. Ky projekt u përcaktua pa asnjë garë, duke ju mohuar kompanive shumë presigjioze shqiptare apo të huaja të marrin pjesë në tenderin për projektimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar dhe përreth tij.

Menjëherë pas kësaj, u miratua ligji special që përcaktonte shprehimisht kompaninë “Fusha” sh.p.k., si subjektin e vetëm ekonomik me të cilin do të negociohej për ndërtimin e Teatrit Kombëtar. Ky ligj vinte në kundërshtim të hapur me Kushtetutën e Shqipërisë, Marrëveshjen e Stabilizimi-Asociimit, ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe ligjin Nr. 139/2015 “Për veteqeverisjen vendore”. Komisioni Evropian konstatoi se ligji special vinte në kundërshtim me nenet 72 dhe 74 të MSA-së, sa i përket parimeve të konkurrencës së lirë dhe mosdiskriminimit. Më pas, Kuvendi do të miratonte një ligj të amenduar, i cili pavarësisht se hoqi emrin e kompanisë “Fusha” sh.p.k., sërish përmbante kritere që vetëm kjo kompani mund t’i përmbushte. Një ndër këto kritere, kishte të bënte me faktin se kompanitë e interesuara duhet të kishin arritur marrëveshje me pronarët kufitarë të pronës së Teatrit Kombëtar. Kompania “Fusha”, duke qenë pronare kufitare, kishte mundësi që të pengonte kualifikimin e cdo kompanie tjetër, duke mospranuar lidhjen e marrëveshjes. Shtuar këtu

edhe faktin që tashmë kompania "Fusha" kishte arritur një marrëveshje të tillë.

Veprimet e kryera më pas nga qeveria dhe Bashkia Tiranë do të provonin se kjo kompani ishte paracaktuar si fituese. U ngrit Komisioni për vlerësimin dhe negocimin e ofertave për ndërtimin e Teatrit Kombëtar, përbërja e të cilit nuk u bë kurrë publike në shkelje të ligjit LIGJ Nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit". Ky Komision nuk bëri publike as ofertat e dorëzuara brenda afatit të përcaktuar dt 9 shtator 2019. E do të negocionte deri në fund vetëm me kompaninë "Fusha" kjo bazuar në deklaratat e Kryetarit të Bashkisë Erjon Veliaj. Kjo praktikë tërësisht e paligjshme e ndjekur nga qeveria dhe Bashkia Tiranë do t'i hiqte mundësinë cdo kompanie shqiptare apo të huaj për të shprehur interesin apo për të marrë pjesë në garën për Teatrin e ri Kombëtar. Veprime të tilla të kryera në bashkëpunim dhe në mënyrë të përsëritur përmbushin plotësisht anën objektive të veprës penale të "Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", pasi veprimet e kryera nga qeveria dhe bashkia kanë pasur një qëllim të vetëm: favorizimin e një kompanie të vetme, kompanisë "Fusha" sh.p.k., dhe të një projekti konkret, të përgatitur nga Bjarke Ingels, duke përjashtuar cdo kompani apo subjekt tjetër të interesuar.

Subjekti: Subjekti i veprës penale ka të bëjë me personin që nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve të tij kryen veprën penale. Në rastin e veprës penale të "Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", subjekti është i posaçëm pasi ai detyrimisht duhet të jetë i përfshirë drejtëpërdrejtë në procedurat e tenderimit. Në rastin konkret, subjekte të veprës penale janë shtetasi Edi Rama, me detyrë Kryeministër, dhe shtetasi Erion Veliaj, me detyrë kryetar i Bashkisë Tiranë, si dhe çdo nëpunës i këtyre dy institucioneve, i cili ka qenë i përfshirë në mënyrë direkte në procedurat e tenderimit. Këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, dhe në mënyrë të përsëritur, kanë shkelur barazinë e subjekteve ekonomike në tenderin përkatës, me qëllim favorizimin e një kompanie të caktuar.

Ana subjektive: Ana subjektive e veprës penale lidhet me aftësinë e personit për të kuptuar pasojat e veprimeve të tij dhe qëndrimin psikik që mban personi ndaj veprimit/mosveprimit të paligjshëm dhe pasojave të dëmshme. Në rastin e veprës penale të "Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", veprimet e paligjshme kryhen me dashje të drejtëpërdrejtë, pasi subjekti i posaçëm parashikon pasojat e veprimeve të tij dhe me dashje kërkon ardhjen e tyre. Pra, subjekti i posaçëm me veprimet e tij aktiv është i vetëdijshëm që po

shkel barazinë e një operatori ekonomik me qëllim favorizimin e operatorëve të tjerë. Në rastin konkret, shtetasi Edi Rama në bashkëpunim me shtetasin Erion Veliaj, dhe nëpunës të tjerë të qeverisë dhe Bashkisë Tiranë, kanë kryer cdo veprim të mundshëm për të projektin e kompanisë “Fusha” dhe të arkitektit Bjarke Ingels në fitimin e projektit për ndërtimin e Teatrit Kombëtar, duke përjashtuar qëllimisht pjesëmarrjen e cdo kompanie apo subjekti tjetër të interesuar. Për sa më sipër, përmbushen në mënyrë kumulative të katër elementët e veprës penale të “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike” për shtetasit Edi Rama, Erion Veliaj dhe cdo nëpunës tjetër i përfshirë në procedurat e shpjeguara më sipër.

B. Vepra penale e “Shpërdorimit të detyrës”:

Objekti: Objekti i veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” ka të bëjë me mbrojtjen e veprimtarisë së rregullt të organeve shtetërore nga veprimet ose mosveprimet e kundërligjshme. Konkretisht, marrëdhënia juridike që synohet të mbrohet është funksionimi në mënyrë të rregullt i veprimtarisë së Këshillit të Ministrave, Bashkisë Tiranë, Institutit të Ndërtimit, Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Policisë së Shtetit. Drejtuesit e këtyre institucioneve, përkatësisht shtetasit Edi Rama, Erion Veliaj, Toni Gogu dhe Agron Hysenlliu, Dallëndyshe Bici, drejtuesve të drejtorive në Bashkinë Tiranë, në bashkëpunim me njëritjetrin, kanë kryer një sërë veprimesh të paligjshme, të cilat kanë dëmtuar rëndë interesat e ligjshëm të shtetit dhe shtetasve.

Ana objektive: Vepra penale e “Shpërdorimit të detyrës” kryhet nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme, që konsiderohen mospërmbushje e rregullt e detyrës, si rezultat i të cilave kanë ardhur dëme të rënda, për interesat e ligjshëm të shtetit apo shtetasve. Përmbushja e këtij elementi të veprës penale kërkon (i) kryerjen ose moskryerjen e një veprimi; (ii) në kundërshtim me ligjin; (iii) nga personi që ushtron funksione publike; dhe (iv) që sjell përfitime materiale ose jomateriale ose dëmtojnë interesat e ligjshëm të shtetit, shtetasve apo personave të tjerë juridikë.

Në rastin konkret, Këshilli i Ministrave, me titullar shtetasin Edi Rama, ka vendosur kalimin e pronësisë Bashkisë Tiranë, me qëllim shembjen e godinës aktuale të Teatrit Kombëtar dhe ndërtimin e një teatri të ri. Ky vendim përmban dy paligjshmëri në vetvete. Së pari, një vendim i tillë vjen në kundërshtim me nenet 3 të Kushtetutës së Shqipërisë, që përcakton se mbrojtja e trashëgimisë kulturore është një ndër themelet e shtetit shqiptar. Godina e Teatrit Kombëtar, e cila për mëse 80 vite kishte shërbyer si një pikë e rëndësishme historike dhe kulturore, është

qartazi një objekt me vlera të trashëgimisë kulturore, në kuptim të ligjit "Për muzetë dhe trashëgiminë kulturore". Së dyti, vendimmarrja për prishjen e një godine që shërben si Teatër Kombëtar, dhe ndërtimin e një teatri të ri, në kuptim të ligjit Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" dhe Rregulloren "Për zhvillimin e territorit", është qartazi kompetencë e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe jo e Këshillit të Ministrave apo e Këshillit Bashkiak.

Pas kësaj vendimmarrje antikushtetuese dhe të paligjshme të qeverisë së drejtuar nga shtetasi Edi Rama, kryetari i Bashkisë Tiranë, shtetasi Erion Veliaj dhe drejtuesit e të gjitha drejtorivë në Bashkinë Tiranë, i kanë propozuar Këshillit Bashkiak Tiranë një vendim po aq të paligjshëm për shembjen e godinës së Teatrit Kombëtar. Kjo pasi, Këshilli Bashkiak Tiranë, në kuptim të ligjit Nr. 139/2015 "Për veteqeverisjen vendore", nuk ka në asnjë prej 19 kompetencave të tij të drejtën për të vendosur shembjen e një godine teatër kombëtar. Për më tepër, është e qartë se kjo kompetencë i përket vetëm Këshillit Kombëtar të Territorit. Paligjshmërinë e kryetarit të Bashkisë Tiranë, drejtuesve të drejtorive të Bashkisë tiranë, e ka vijuar më tej kryetari i Këshillit Bashkiak Tiranë, shtetasi Toni Gogu, i cili në shkelje të të gjitha parashikimeve ligjore dhe dispozitave të Rregullores së Këshillit Bashkiak Tiranë për thirrjen e një séance, njoftimin e rendit të ditës, kuorumin e nevojshëm dhe votimin e një vendimi, ka nënshkruar Vendimin Nr. 50, datë 14.05.2020 të Këshillit Bashkiak Tiranë. Duke vepruar kështu, shtetasi Toni Gogu ka shkelur haptazi ligjin "Për veteqeverisjen vendore" dhe Rregulloren e Këshillit Bashkiak Tiranë, të cilat diktojnë haptazi vendimmarrjen e tij.

Vendimi i paligjshëm i Këshillit Bashkiak Tiranë është bazuar mbi një akt-ekspertizë Nr. 1026/1 Prot., datë 13.05.2020 të Institutit të Ndërtimit, me titullar shtetasin Agron Hysenlliu. Ky i fundit, duke iu referuar një akt-ekspertimi të kryer në vitin 2018, i ka sugjeruar Këshillit Bashkiak Tiranë shembjen e godinës së Teatrit Kombëtar. Shtetasi Agron Hysenlliu, së bashku me disa arkitektë/inxhinierë të institutit të tij, kanë arritur në përfundimin se godina e Teatrit Kombëtar duhet shembur pa qenë present në Teatrin Kombëtar, pa bërë asnjë matje, asnjë vizitë, asnjë test profesional. MADje tre prej tyre, nuk kanë qenë pjesë as të Aktit të parë të ekspertimit të vitit 2018. Duke ardhur në një përfundim të tillë, shtetasi Hysenlliu dhe inxhinierët e tjerë, pa kryer veprimet e nevojshme profesionale për konstatimin e fakteve, kanë kryer veprime të paligjshme, të cilat kanë pasur si pasojë shembjen e Teatrit Kombëtar, një dëm shumë i rëndë për interesat e ligjshëm të shtetit.

Ajo cka e bën edhe më të rëndë situatën, është se qoftë në akt-ekspertimin e vitit 2018, ashtu edhe në shkresën e vitit 2020, nuk ka asnjë akt konstatim për godinën e Teatrit Eksperimental, e cila ishte rikonstruktuar vitet e fundit dhe ishte në gjendje mjaft të mirë. Para, 60 anëtarë të Këshillit bashkiak kanë vendosur për shembjen e një godine, Teatrit Eksperimental, pa pasur as edhe një akt ekspertimi dhe konstatimi.

Subjekti: Subjekti i veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” është i posacëm, pasi kjo vepër penale mund të kryhet vetëm nga personi që kryen një detyrë publike. Konkretisht, subjekte të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” janë shtetasi Edi Rama, me detyrë kryetar i Këshillit të Ministrave, shtetasi Erion Veliaj, me detyrë kryetar i Bashkisë Tiranë, shtetasi Toni Gogu, kryetar i Këshillit Bashkiak Tiranë, dhe shtetasi Agron Hysenlliu, me detyrë drejtor i Institutit të Ndërtimit, si dhe të gjithë shtetasit e tjerë të përfshirë në mënyrë direkte apo indirekte në veprimet e paligjshme të kryera nga shtetasit e mësipërm.

Ana subjektive: Vepra penale e “Shpërdorimit të detyrës” kryhet me dashje të drejtpërdrejtë, pasi personi që kryen funksionin publik është i vetdijshëm për veprimet e tij të paligjshme dhe dëshiron ardhjen e pasojave të tyre. Konkretisht, sic rezulton nga faktet e shpjeguara më sipër, shtetasi Edi Rama ka pasur për qëllim shembjen e godinës së Teatrit Kombëtar që në vitin 1998 kur ai ishte Ministër i Kulturës. Të njëjtën dëshirë dhe qëllim kanë pasur edhe shtetasit Erion Veliaj, Toni Gogu dhe Agron Hysenlliu, të cilët kanë kryer veprimtari të paligjshme në bashkëpunim me shtetas të tjerë, duke pasur për qëllim prishjen e godinës aktuale të Teatrit Kombëtar dhe ndërtimin e një godine të re nga një kompani e parazgjedhur nga ana e kryeministrit në shkelje të ligjit e pa garë. Kjo provohet edhe nga fakti se pas prishjes së godinës së Teatrit Kombëtar, kompania “Fusha” sh.p.k. do të deklaronte se ata do të vazhdonin projektet e tyre, të cilave Bashkia Tiranë mund t’u bashkëngjitej (prova: audio e telefonatës më Fushën). Qëllimet e paligjshme dhe kriminale të këtyre shtetasve kanë cuar më pas në shkatërrimin e një objekti me vlera të rëndësishme historike, kulturore dhe artistike për vendin tonë, dhe për Europën. Është kjo arsyeja pse Europanostra e vendosi Teatrit Kombëtar në listën e 7 siteve me vlera të cmuara të trashëgimisë kulturore e më të rrezikuara. (<https://www.europanostra.org/europe-7-most-endangered-heritage-sites-2020-announced/>)

C. Vepra penale e “Përvetësimit të titullit apo detyrës shtetërore”:

Objekti: Objekti i veprës penale të “Përvetësimit të detyrës shtetërore”, si në të gjitha rastet e veprave penale kundër autoritetit të shtetit të parashikuara në Kreun VIII të Kodit Penal, ka të bëjë me mbrojtjen e posacme të marrëdhënieve juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt të organeve shtetërore, si dhe liritë e të drejtat themelore të shtetasve, nga veprimet ose mosveprimet kriminale. Me përvetësim të detyrës shtetërore duhet kuptuar marrja dhe ushtrimi në mënyrë të padrejtë të të drejtave apo kompetencave që i takojnë një funksionari publik për shkak të pozicionit të tij. Në rastin konkret, marrëdhënia juridike që kërkohet të mbrohet është përmbushja në mënyrë të plotë e kompetencave që ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ka dhënë Këshillit Kombëtar të Territorit për të vendosur dhënien e lejes për prishjen një godine teatër kombëtar, dhe ndërtimin e një godine të re të njëjtës kategori. Organet shtetërore kanë detyrimin ligjor, jo vetëm për të mos ndërhyrë në kompetencat e Këshillit Kombëtar të Territorit, por të marrin masat e nevojshme për përmbushjen në mënyrë të rregullt të këtyre kompetencave. Respektimi i kompetencave të KKT-së është sigurisht detyrim ligjor edhe i Këshillit Bashkiak Tiranë dhe Këshillit Teknik pranë Bashkisë së Tiranës. Këta të fundit, me veprimet e tyre dhe me dashje të drejtpërdrejtë, kanë uzurpuar në mënyrë të paligjshme një kompetencë eskuzive të KKT-së.

Ana objektive: Ana objektive e veprës penale të “Përvetësimit të detyrës shtetërore” lidhet me veprimet e kundërligjshme që shfaqen në përvetësimin e titullit apo detyrës që të shoqërohet me kryerjen e veprimeve që i takojnë mbajtësit të titullit apo detyrës. Pra, përmbushja e këtij elementi të veprës penale kërkon që të përmbushen njëkohësisht dy kushte: (i) kryerja e veprimeve të paligjshme, dhe (ii) kryerja e veprimeve që i takojnë mbajtësit të detyrës. Në rastin konkret, veprimet e kryera nga Këshilli Bashkiak Tiranë përmbushen të dy këto kushte. Neni 54 i ligjit Nr. 139/2015 “Për veteqeverisjen vendore” përmban të gjitha kompetencat e Këshillit Bashkiak. Në asnjë gjermë, në asnjë pikë, në asnjë nen nuk parashikohet e drejta e Këshillit Bashkiak për të vendosur prishjen e një ndërtese, aq më pak kur bëhet fjalë për ndërtesa të rëndësisë kombëtare, sic përcaktohet nga ligji dhe rregullorja për zhvillimin e territorit. Pra, Këshilli Bashkiak Tiranë ka vepruar në mungesë të kompetencës, cka do të thotë se të gjitha veprimet e tij janë kryer në mënyrë të paligjshme.

Neni 28 i ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” ka parashikuar qartë se Këshilli Kombëtar i Territorit është përgjegjës për dhënien e lejeve për prishjen e objekteve të rëndësisë kombëtare.

Ndërsa, neni 19 i Rregullores për zhvillimin e territorit përcakton se KKT ka të drejtën ekskluzive për të vendosur prishjen/ndërtimin e një objekti teatër kombëtar. Kjo do të thotë se Këshilli Bashkiak Tiranë ka përvetësuar në mënyrë të paligjshme një kompetencë, të cilën ligji ia ka dhënë ekskluzivisht vetëm Këshillit Kombëtar të Territorit. Pra, Këshilli Bashkiak Tiranë, me propozimin e kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit Erion Veliaj, i drejtuar nga shtetasi Toni Gogu, kryetar i Këshillit Bashkiak Tiranë, dhe anëtarët e këtij Këshilli Bashkiak apo Këshillit Teknik, kanë kryer veprimtari të paligjshme duke vepruar në mungesë të kompetencës ligjore dhe duke ushtruar një detyrë që i përket një organi tjetër shtetëror.

Subjekti: Subjekti i veprës penale të përvetësimit të detyrës shtetërore mund të jetë cdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm. Në rastin konkret, subjekte të veprës penale janë shtetasi Erion Veliaj, me detyrë kryetar i Bashkisë Tiranë, shtetasi Toni Gogu, me detyrë kryetar i Këshillit Bashkiak Tiranë, të gjithë anëtarët e Këshillit Bashkiak Tiranë, dhe anëtarët e Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë, të cilët kanë vepruar në mungesë të kompetencës ligjore, duke uzurpuar në mënyrë të paligjshme të drejtat që i takojnë vetëm Këshillit Kombëtar të Territorit.

Ana subjektive: Vepra penale e përvetësimit të detyrës shtetërore kryhet me dashje të drejtëpërdrejtë, cka do të thotë se subjektet e kësaj vepre i parashikojnë pasojat e veprimeve të tyre dhe me vetëdije lejojnë ardhjen e tyre. Në rastin konkret, subjektet e veprës penale shtetasit Erion Veliaj, Toni Gogu, anëtarët e Këshillit Bashkiak Tiranë dhe anëtarët e Këshillit Teknik, kanë qenë plotësisht të vetëdijshëm për pasojat e veprimeve të tyre dhe kanë kryer cdo veprim të nevojshëm për ardhjen e pasojave. Qoftë publikisht apo privatisht, ata janë shprehur për qëllimin e tyre për prishjen e kompleksit të Teatrit Kombëtar, edhe pse ishte shumë e qartë se kjo kompetencë nuk i takonte kurrësesi Këshillit Bashkiak Tiranë. Për sa më sipër, është plotësisht e qartë se përmbushen të katër elementët e veprës penale të "Përvetësimit të detyrës shtetërore" për të marrë në përgjegjësi penale shtetasit e sipërcituar.

D. Vepra penale e "Shkatërrimit të pronës me mjete të tjera":

Objekti: Objekti i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar paprekshmërinë e pronës private apo publike, mjedisi, jeta dhe shëndeti i njerëzve, nga veprimet ose mosveprimet kriminale, që mbrohen posacërisht nga legjislacioni penal. Objekti material është prona publike ose private, e cila ka një vlerë të caktuar.

Në rastin konkret, marrëdhënia që synohet të mbrohet është kompleksi i Teatrit Kombëtar, pjesë e të cilit ishin dy godina që shërbenin si teatro kombëtare, përkatësisht Teatri Kombëtar dhe Teatri Eksperimental. Po ashtu, edhe mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve, të cilët gjatë ndërhyrjes së kryer nga ana e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Policisë së Shtetit gjendeshin akoma në godinë ndërkohë që kishte filluar shembja. Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Policia e Shtetit, në zbatim të një vendimi të paligjshëm, i cili gjithësesi nuk kishte hyrë akoma në fuqi, kanë shkatërruar dy godinat e Teatrit Kombëtar, pavarësisht se në pronësi të Bashkisë ishte vetëm teatri eksperimental, duke rrezikuar seriozisht jetën dhe shëndetin e njerëzve që gjendeshin akoma në godinë.

Ana objektive: Nga ana objektive, vepra penale kryhet me veprime aktive, duke përdorur mjete, të cilat vendosin në rrezik serioz jetën dhe shëndetin e njerëzve. Në rastin konkret, Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit me mbështetjen e Policisë së Shtetit kanë ndërhyrë për të shembur dy godinat e kompleksit të Teatrit Kombëtar. Për këto ndërhyrje arbitrare është përdorur si bazë ligjore vendimi Nr. 50, datë 14.05.2020 të Këshillit Bashkiak Tiranë. Megjithatë, rezulton se në datën 17 Maj 2020, kur është realizuar ndërhyrja ky vendim nuk kishte hyrë akoma në fuqi, në kuptim të nenit 55, pika 6 të ligjit Nr. 139/2015, e cila është baza ligjore e cituar edhe në vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë. Nga ana tjetër, prona që po shembej nuk ishte në pronësi të Bashkisë Tiranë. Për shembjen e godinës së Teatrit Kombëtar janë përdorur buldozerë, ndërkohë që në godinë gjendeshin akoma njerëz. Fillimi i shembjes së godinës të Teatrit Kombëtar, ndërkohë që në godinë kishte akoma njerëz, ka vendosur në rrezik serioz jetën dhe shëndetin e këtyre njerëzve.

Subjekti: Për këto veprime tërësisht të paligjshme dhe të cilat kanë krijuar rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, personat, të cilët duhet të merren në përgjegjësi penale janë zyrtarët Bici dhe Qato. Këta shtetas, në bashkëpunim me Erion Veliaj dhe në bashkëpunim me njëritjetrin kanë urdhëruar vartësit e tyre për të shkatërruar në mënyrë të paligjshme dy objekte të rëndësisë kombëtare, duke u bazuar në një vendim tërësisht të paligjshëm dhe pa patur një leje prishje nga organi kompetent sipas ligjit. Është detyrë dhe përgjegjësi e drejtpërdrejtë e çdo zyrtari, që të mos zbatojë asnjë vendim, urdhër apo udhëzim të paligjshëm, pasi kjo nuk e përjashton nga përgjegjësia penale. Kjo do të thotë se zbatimi i një vendimi të paligjshëm, nuk i shkarkon nga përgjegjësia shtetasit e sipërcituar. Këta shtetas duhen marrë në

përgjegjësi penale për konsumimin haptazi të një vepre penale, e cila mund të kishte rezultuar me pasoja fatale për jetën e shumë njerëzve.

Ana subjektive: Nga ana subjektive, shkatërrimi i pronës me mjete të tjera kryhet me dashje. Në rastin konkret, zyrtarët publik të lartëpërmendur, urdhëruesit dhe vartësit e tyre kanë vepruar me dashje të drejtpërdrejtë për shkatërrimin e dy godinave të Teatrit Kombëtar. Qëllimi kriminal i prishjes së godinave të Teatrit Kombëtar duke përdorur mjete të rënda buldozerë, nuk ka kursyer as jetën dhe shëndetin e njerëzve, të cilët mund të ishin shndërruar në viktima të këtyre veprimeve kaq të rënda. Për sa më sipër, përmbushen të katër elementët e veprës penale të "Shkatërrimit të pronës me mjete të tjera", për marrjen në përgjegjësi penale të shtetasve të sipërcituar.

Së fundmi, nisur nga fakti i një rreziku eminent që paraqet disponimi i lirë i këtij sendi (truallit të Teatrit Kombëtar dhe *projektit të hartuar nga arkitekti z. Bjarke Ingels me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar"*), që lidhet me veprat penale të cituara më sipër, mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e tyre apo të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, kërkojmë nga prokuroria që të paraqesë në gjykatën kompetente kërkesën për urdhërimin e vendosjes së sekuestros preventive ndaj këtij projekti. Kjo kërkesë është në përputhje me nenin 274 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak se jemi përpara një sendi (*projektit*) që ka shërbyer ose është caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale. Vendosja e sekuestros preventive ndaj këtij projekti do të ishte edhe një masë që parandalon pasojat e parikuperiushme dhe jashtëzakonisht të dëmshme për interesin publik që ka realizimi i atij projekti.

Z. Prokuror,

Me anë të këtij kallëzimi që ju paraqesim, marrim përsipër të bëhemi përcues të zërit të atyre qytetarëve të ndershëm të këtij vendi të cilët besojnë se vetëm zbatimi i ligjit do ta çojë drejt përsosjes shoqërinë tonë. Të atyre qytetarëve të cilët besojnë se ligji është një dhe i barabartë për të gjithë. Të artistëve, urbanistëve, arkitektëve, inxhinjerëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe qytetarëve, që kundërshtojnë me forcë realizimin e këtij projekti, që shkatërroi ndërtesën historike të Teatrit Kombëtar dhe i hap rrugë një biznesi ndërtimi të Kullave në Qendrën Historike të Tiranës, për motive të errta dhe të dyshuara si korruptive.

Faktet e bëra publike deri më tani, do të mjaftonte që vetë organi i prokurorisë të kishte nisur hetim kryesisht për këtë çështje, duke

përbushur në këtë mënyrë përgjegjësitë e veta kushtetuese dhe ligjore. Duke dashur të besojmë se mos nisja e hetimeve mbi këtë aferë ka ardhur jo për mungesë të vullnetit të organit të prokurorisë për të përbushur me korrektësi përgjegjësitë e veta apo për të vijuar kulturën e pandëshkueshmërisë për afëra korruptive, Partia Demokratike e Shqipërisë paraqet këtë kallëzim, si mundësi ligjore e ushtrimit të përgjegjësisë tonë në mbrojtje të interesit publik.

Përfundimisht, nga sa analizuar më sipër rezulton se janë ezauruar të gjitha elementet e veprave penale konkrete të përcaktuara në objektin e këtij kallëzimi penal, dhe për pasojë organet ligjzbatuese duhet të veprojnë pa asnjë hezitim të mëtejshëm dhe me profesionalizëm të lartë të diktuar nga interesi i lartë që është cenuar dhe preket në këtë rast, duke qenë se jemi përpara një projekti që asgjësoi shtetin ligjor në vend, që cenoi trashëgiminë kulturore shqiptare e europiane, dhe që ligjëron korrupsionin në Shqipëri.

PËR KËTË ARSYE:

Në mbështetje të nenit 280 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, nga ana e organit të prokurorisë,

KËRKOJMË:

- 1-** Regjistrimin dhe fillimin e procedimit penal ndaj subjekteve kundër të cilëve paraqitet ky kallëzim për kryerjen e veprës penale të "Shkatërrimi i pronës" parashikuar nga neni 150 i K.Penal, "Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera" parashikuar nga neni 154 i K.Penal, "Shkatërrimi i veprave kulturore" parashikuar nga neni 160 i K.Penal, "Përvetësimi të titullit apo detyrës shtetërore", parashikuar nga neni 246 i K.Penal, "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i K.Penal, "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", parashikuar nga neni 258 i K.Penal, "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" parashikuar nga neni 259 i K.Penal, "Korrupsioni pasiv i funksionareve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendore", parashikuar nga neni 260 i K.Penal, "Organizata kriminale" parashikuar nga neni 333 i K.Penal dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga neni 334 i K.Penal.
- 2-** Kryerjen e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme për sqarimin më të saktë e më të plotë të rrethanave të

parashtruara më sipër, si dhe kryerjen e një hetimi të plotë dhe të gjithëanshëm për aferën e projektit zhvillimor me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar", me pikënisje ftesën e që arkitekti Bjarke Ingels deklaroi se ka marrë në vitin 2016 nga Kryeministri dhe Kryetari i Bashkisë Tiranë për realizimin e projektit të Teatrit Kombëtar e deri në prishjen e godinës së Teatrit Kombëtar.

3- Paraqitjen e kërkesës në gjykatë për vendosjen e sekuestros preventive për truallin e transferuar në favor të Bashkisë Tiranë me anë të VKM Nr. 377, datë 8.5.2020 "Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin "Teatri Kombëtar", në zonën kadastrale 8150, Tiranë"; si dhe ndaj projektit me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar", të realizuar nga studio "BIG-BJARKE INGELS GROUP", sipas nenit 274 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

Duke ju uruar punë të mbarë,

K A L L Ë Z U E S I:

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

Përfaqësuar nga

**Sekretari i Përgjithshëm
Gazment Bardhi**